

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Të drejtat e viktimave të trafikimit
gjatë procesit penal

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2017

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose rishtypet me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet OSBE-së. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të OSBE-së.

Autorët: Sandër Simoni (Kapitujt 1 & 4)
Aurela Anastasi (Kapitulli 3)
Elizabeta Imeraj (Kapitulli 2)

Redaktore shkencore: Juliana Rexha

ISBN: 978-9928-4472-1-0

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pozicionin e Prezencës së OSBE-së.

Parathënie

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen global në rritje dhe një prej kërcënimeve ndërkombëtare të kohës sonë, i cili vë në rrezik të drejtat e njeriut dhe vlerat themelore të shoqërive demokratike. Sipas të dhënave të besueshme, trafikimi i qenieve njerëzore është biznesi i tretë i paligjshëm në botë pas atij të trafikimit të armëve dhe narkotikëve¹.

Trafikimi në njerëz vazhdon të jetë një problem serioz për Shqipërisë, si përsa i përket trafikimit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, pavarësisht të gjitha përpjekjeve për ta luftuar. Që prej ratifikimit të Protokollit të Kombeve të Bashkuara për Trafikimin e Personave, Shqipëria e ka përfshirë këtë vepër penale në legjislacionin e saj. Në dekadën e fundit, janë bërë disa ndryshime në legjislacion për të siguruar pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare. Falë këtyre ndryshimeve ligjore, autoritetet kanë mundur të sigurojnë mbrojtje për viktimat dhe të ndjekin penalisht autorët. Megjithatë, për fat të keq, ndjekja penale dhe gjykimi i rasteve nuk janë të kënaqshme.

Aktualisht, drejtësia penale në fushën e anti-trafikimit është kryesisht e përqendruar në ndjekjen penale të autorëve, ndërsa po përmirësohet mbrojtja e viktimave. Kjo lloj qasjeje në mbrojtjen e të drejtave të viktimës paqyrohet dhe në Planin e Veprimit të OSBE-së për Masat kundër Trafikimit të Personave, i cili bazohet në masa gjithëpërfshirëse ndaj trafikimit të personave. Ky Plan Veprimi përqendrohet në masa ndaj ndërkombëtarëve të trafikantëve, ndërkohë që vihen në zbatim veprime për mbrojtjen dhe asistencën ndaj viktimave.

Ndryshimet në Kodine Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë në vitin 2017 parashikojnë dispozita të reja për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, veçanërisht në përmirësimin e statusit të viktimës gjatë procesit penal. Ndryshimet e lartpërmendura gjithashtu parashikojnë se veprat penale të trafikimit të personave nuk do të referohen automatikisht pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda, përveçse kur ndodhin në kontekstin e krimit të organizuar. Për të lehtësuar punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me këto ndryshime, Prezenca e OSBE-së ka mbështetur hartimin e këtij komentari, me qëllim që të zbatohet siç duhet legjislacioni penal në fushën kundër trafikimit të personave. Ky komentari trajton çdo fazë të procedimit penal, si gjatë hetimit dhe gjatë gjykimit. Analiza dhe rekomandimet në këtë komentari synojnë të udhëzojnë drejt zbatimit të duhur të legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare, duke nxitur mbrojtjen e të drejtave të viktimës në të gjitha fazat e procedimit penal.

Në mbyllje, shpresoj që ky komentari do të kontribuojë në rritjen e dënimeve ndaj trafikantëve dhe në përmirësimin e mbrojtjes së viktimave të trafikimit në Shqipëri.

Bernd Borchardt

Ambasador

Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

¹ Sipas UNODC: https://www.unodc.org/wdr2017/field/Booklet_5_NEXUS.pdf

Përmbajtja

Parathënie	3
1. KONCEPTI I TRAFIKIMIT NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR	6
1.1 Koncepti i trafikimit të personave në të drejtën ndërkombëtare	6
1.2 Standardet ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e veprave penale të trafikimit dhe trajtimin e viktimës.	12
1.3 Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me detyrimin e shteteve për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.	15
1.4 Koncepti i trafikimit në legjislacionin penal shqiptar.	21
1.4.1. Trafikimi i brendshëm sipas Kodit tonë Penal.	32
1.4.2. Dallimi ndërmjet trafikimit të personave të rritur dhe shfrytëzimit të prostitucionit.	32
1.4.3. Dallimi ndërmjet trafikimit të të miturit nga keqtrajtimi i të miturit (lypja e detyruar apo shfytëzimi në punë të detyruar).	33
Bibliografi:	35
2. NDJEKJA PENALE DHE MËNYRAT E FILLIMIT TË SAJ	37
2.1 Kallëzimi i bërë nga viktimë e trafikimit.	37
2.2 Marrja dijëni për veprën penale nga familjarët e viktimës së trafikimit.	41
2.3 Marrja dijëni për veprën penale nga persona të tjerë.	43
2.4 Fillimi i ndjekjes penale pas referimit të bërë nga policia e shtetit.	45
2.5 Marrja dijëni për veprën penale si rezultat i deportimit të viktimës së trafikimit.	49
2.6 Marrja dijëni për veprën penale nga materialet e ardhura autoritetet ndërkombëtare.	50
3. TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË PROCESIN PENAL (neni 58, 58/b i Kodit të Procedurës Penale).	51
3.1 Klasifikimi i të drejtave të viktimës në procesin penal.	51
3.1.1 Klasifikimi sipas përkatësisë së tyre.	51
3.2 Të drejtat e viktimës në kuptimin e përgjithshëm.	52
3.2.1. Të drejtat e viktimës për informim dhe mbështetje.	52
3.2.2 Të drejtat e viktimës për të marrë pjesë në procesin penal.	53
3.2.3 Të drejtat që lidhen me mbrojtjen e viktimave.	54
3.3 Të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në kuptimin e posaçëm.	54

3.4 Të drejta të tjera të parashikuara për viktimat në procesin penal.	55
3.4.1 Të drejtat që parashikohen për trashëgimtarët e viktimave.	55
3.5 Klasifikimi i të drejtave të viktimave bazuar në mënyrën e ushtrimit të tyre.	56
3.5.1 Të drejtat e viktimës që ushtrohen mbi bazën e kërkesës së tyre.	56
3.5.2 Të drejtat e viktimës që ushtrohen drejtpërdrejt nga organet e drejtësisë.	57
3.6 Çështje të aksesit në drejtësi të viktimave të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Nevoja për një mentalitet të ri të profesionistëve të drejtësisë.	58
3.6.1 E drejta e viktimës për t'u mbrojtur me avokat.	58
3.6.2 E drejta e viktimës për t'u përjashtuar nga shpenzimet.	59
3.6.3 E drejta e viktimës të kërkojë shpërblimin e dëmit në procesin penal	60

4. GJYKIMI I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE.

4.1 Çështje të gjyqimit të veprave penale të trafikimit dhe kompetencës lëndore të tyre. Ndryshimet e reja ligjore në legjislacionin procedural.	62
4.2 Ndryshimet e reja në legjislacionin tonë penal dhe procedural.	64
4.3 Gjykimi i veprave penale të trafikimit dhe të drejtat e viktimave gjatë procesit gjyqësor penal.	65
4.4 Prania e viktimës së trafikimit në seancë gjyqësore dhe pyetja e saj me cilësinë e dëshmitares në seancë gjyqësore.	72
4.5 Pyetja e të miturit viktimë e trafikimit.	75
Bibliografi:	80

Sandër Simoni

Kryetar i Gjykatës për Krime të Rënda, Pedagog i Jashtëm në Shkollën e Magjistraturës

1. KONCEPTI I TRAFIKIMIT NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR

1.1 Koncepti i trafikimit të personave në të drejtën ndërkombëtare.

Trafikimi i qenieve njerëzore është krim me natyrë mbarë botërore, që nuk njih kufij, shkel të drejtat themelore të njeriut, vlerat humane të shoqërive demokratike, prandaj dhe si i tillë ai trajtohet nga e drejta ndërkombëtare në kuadër të disa normave.

Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut që bazohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948, në vetvete nuk citon shprehimisht trafikimin. Por neni 4 i saj ndalon “*skllavërinë dhe tregtinë e skllevërve në të gjitha format e tyre*”. Trafikimi i sotëm është “*skllavërimi modern*” i qenieve për punë, përfitime seksuale etj, duke e shndërruar qenien njerëzore në një mjet përfitimi. Sipas së drejtës ndërkombëtare trafikimi i qenieve njerëzore nënkupton shfrytëzimin për punë, shërbime seksuale apo përfitime të tjera të njeriut duke përdorur forma veprimi kriminal që vesojnë vullnetin e individit dhe e trajtojnë atë si një send mbi të cilin veprohet kriminalisht.

Dy normat kryesore ndërkombëtare të cilat trajtojnë nga pikëpamja juridike ndërkombëtare fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe nevojën për reagimin ndaj tij janë:

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar² me dy protokollet e saj plotësuese:
 - Protokoli Kundër Trafikimit të Migrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrorë dhe Detare.
 - Protokoli mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve (*Protokoli i Palermos*).

² Kjo Konventë dhe dy protokollet e saj janë ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së OKB Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj.

2. Konventa e Këshillit të Evropës për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, (*Konventa e Varshavës*)³.

Konventa e OKB, nëpërmjet **Protokollit të Palermos**, përbën aktin ndërkombëtar më të rëndësishën në nivel botëror dhe formën e reagimit më të fortë ndaj fenomenit të trafikimit duke e konsideruar atë një kërcënim për njerëzimin dhe në të njëtin nivel me krimin e organizuar.

Në këtë Konventë jepet përkufizimi i trafikimit të personave sipas së cilit:

“Trafikimi i personave” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen, pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë, ose abuzimit të pushtetit ose pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi.

Shfrytëzimi përfshin së paku shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërisë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitutet.

Pëlqimi i viktimës së trafikimit për shfrytëzimin e qëllimshëm të përmendur në nënparagrafin a) të këtij neni do të jetë e pavend nëse janë përdorur mjetet e parashikuara në nënparagrafin a) Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja e ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet *“trafik personash”* edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin a) të këtij neni.⁴

Sipas përkufizimit sa sipërcituar del se trafikimi i personave është një veprim kriminal i cili nënkupton shfrytëzimin e personit, qoftë ai /ajo i rritur, i mitur, femër për qëllime prostitucioni kryesisht apo shfrytëzimi në punë nëpërmjet veprimeve të tilla si rekrutim, transportim, fshehje, mashtrim, përdorimit të forcës, shfrytëzimit të pozitës së dobët të viktimës etj. Nëse janë përdorur këto forma, pëlqimi i viktimës nuk është i vlefshëm, edhe nëse ajo i ka miratuar ato. Trafikimi i fëmijëve ndryshon nga trafikimi i personave të rritur sepse nuk

³ Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006.

⁴ Neni 3 i Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, pjesë e Konventës.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

është e nevojshme të jenë përdorur «mjetet» e përcaktuara në pjesën e parë të nenit për trafikimin. Sipas Konventës çdo veprim ndaj tyre duke i rekrutuar, transportuar, transferuar, fshehur, apo pritur me qëllim shfrytëzimin e tyre do të konsiderohet trafikim edhe nëse ndaj tij nuk janë përdorur mjetet. Kjo për shkak se në këtë rast norma ndërkombëtare mban parasysh përshtatjen dhe zhvillimin fizik apo mendor të fëmijëve.

Protokolli kërkon që krimi «*trafikim*» të përkufizohet me gërshetimin e tre elementëve përbërës dhe jo me evidentimin veçmas të këtyre komponentëve, edhe pse në disa raste këta elementë përbëjnë vepra penale më vete. Vepra duhet të përfshijë njërin prej proceseve: rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pritjen e një personi.⁵

- Vepra duhet të përmbajë edhe të paktën njërin prej këtyre veprimeve: përdorimin e forcës, kërcënimin se do të përdoret forca, shtrëngimin, rrëmbimin e personit, mashtrimin, shfrytëzimin e pushtetit ose të pozitës së pafavorizuar, dhënien apo marrjen e përfitimeve.
- Personi e ka kryer aktin ose aktet me paramendimin që të “*shfrytëzohet*” viktima (*sikurse përkufizohet nga legjislacioni i brendshëm i një vendi kundër trafikimit*).

Protokolli për Trafikimin nuk e përkufizon shfrytëzimin por jep një listë jo shteruese të formave të shfrytëzimit duke parashikuar se shfrytëzimi përfshin, si minimum, shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, punë shërbëtori ose heqje të organeve.

Protokolli gjithashtu⁶ u kërkon më tej vendeve të sigurojnë që vepra e përcaktuar në nenin 3 të cilësohet si vepër penale në legjislacionin e tyre vendas. Përkufizimi i dhënë në Protokollin për Trafikimin ka për synim të japë një shkallë njëtrajtshmërie dhe konsensusi në mbarë botën, në lidhje me dukurinë e trafikimit të personave; megjithatë, legjislacioni vendas nuk duhet medoemos të ndjekë mënyrën e shprehjes të përdorur në Protokollin për Trafikimin.⁷ Në vend të një gjëje të tillë, është e mira të përshtatet legjislacioni vendas me sistemet ligjore në vend për t’i dhënë fuqi kuptimit dhe koncepteve që përmban Protokollin për Trafikimin.

⁵ Të gjitha këto terma janë përfshirë në legjislacionin tonë të brendshëm në Kodin Penal.

⁶ Në nenin 5 të tij.

⁷ Legjislacioni penal shqiptar pas ratifikimit të këtij Protokollin u përshtat sipas frymës së tij dhe përkufizimi i veprave penale të trafikimit i është përmbajtur *mot a mot* përkufizimeve në këtë Protokoll.

Protokolli nuk e lidh domodoshmërisht shfytëzimin si formë e kryerjes së trafikimit. Siç duket qartë nuk është nevoja të ketë ndodhur fakti i shfrytëzimit. E gjithë ajo që kërkohet është që trafikanti të ketë kryer njërin prej veprimeve përbërës, duke përdorur njërin prej mjeteve të parashikuar në listë me qëllimin ose, për ta thënë ndryshe, me paramendimin për ta shfrytëzuar personin.

Elementi volotiv mund të provohet përmes disa mënyrave dhe kërkohet që legjislacionet vendase ta cilësojnë si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore vetëm kur kryhet me paramendim sipas paragrafit 1 të Nenit 5. Megjithatë, vendet mund të lejojnë që kjo kërkesë të vendoset në një standard më të ulët, domethënë përmes veprës së pakujdesisë, indiferencës së vullnetshme ose, madje, edhe indiferencës penale, në varësi të kërkesave të sistemit ligjor në vend.

Sipas frymës së Protokollit krimi i trafikimit të qenieve njerëzore përbëhet nga komponentë gjeografikë, strukturorë dhe komercialë. Në rastin e trafikimit ndërkuftar, elementët gjeografike dhe strukturorë mund të jenë:

- të vendit të origjinës (rekrutimi dhe eksportimi);
- vendit transit (transportimi);
- vendit të mbërritjes (importimi dhe pritja).

Brenda këtyre tri fushave, karakteristikat komerciale që i përkasin këtij lloj krimi nënkuptojnë që trafikantët përfshihen në një apo më shumë prej veprimtarive të mëposhtme :

- Veprime në kuadër të procesit të rekrutimit ose shfrytëzimit;
- Marrja me qira e ambienteve të qëndrimit të përkohshëm, bazat, motelet apo lokalet, punishtet me krah pune të paligjshëm, fabrikat, etj;
- Transporti nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të identitetit të rreme apo jo të udhëtimit dhe procesi i kalimit tranzit;
- Organizimi i rekrutimit dhe shfrytëzimit;
- Veprimet financiare, kalimi i parave nëpërmjet shoqërive të transmetimit të parave.

Në secilën prej këtyre fazave të procesit të trafikimit mund të ketë material që përdoret si provë dhe organet proceduese policia apo prokuroria duhet të gjejnë

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

mënyra për t'i shfrytëzuar plotësisht këto mundësi për gjetje të provave, duke u kujdesur në të njëjtën kohë të sigurojnë shpëtimin e viktimave, ndalimin, dënimin e trafikantëve dhe konfiskimin e pasurive.

Protokolli për Kontrabandimin e Emigrantëve, parashikon fenomenin e kalimit të paligjshëm të migrantëve ekonomikë, duke parashikuar se: “*Kalimi kontrabandë i migruesve*” është prokurimi, në mënyrë që të fitohet, drejtpërdrejt ose jo, një përfitim financiar ose material, i hyrjes së paligjshme të një personi në një Shtet Palë në të cilin personi në fjalë nuk është as shtetas dhe as me leje banimi të përhershme⁸.

Mirëpo, duhet vërejtur se, në praktikë, nuk është gjithmonë e lehtë të konstatohet dhe të ruhet dallimi midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe kalimit kontrabandë të migrantëve. Për shembull, shumë persona të trafikuar, si meshkuj ashtu edhe femra, e nisin rrugëtimin e tyre si migrantë që kalohen kontrabandë – pasi lidhin kontratë me një person apo me një grup personash për t'i ndihmuar në lëvizjen e tyre në këmbim të përfitimit financiar. Në një situatë klasike kontrabande migrantësh, marrëdhënia midis migrantit dhe kontrabandistit është marrëdhënie vullnetare afatshkurtër, e cila përfundon me mbërritjen e migrantit në vendin e mbërritjes. Mirëpo, disa migrantë që kanë kaluar territorin e një shteti në mënyrë ilegale apo kontrabandë janë të shtrënguar ta vijojnë këtë marrëdhënie, në mënyrë që të mund të shlyejnë kostot e mëdha të transportit. Është pikërisht në këtë fazë të fundit që dalin në pah qëllimet e fundme të trafikimit të qenieve njerëzore (*puna e skllavëruar përmes borxhit, zhvatja, përdorimi i forcës, puna e detyruar, futja me forcë në veprimtari kriminale, pjesëmarrja me forcë në prostitucion*).

Protokolli, ripërsërit *detyrimin e shteteve palë që të ofrojnë ndihmë për viktimat e trafikimit*.⁹ Sipas kësaj dispozite shtetet Palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ të përmbajë masa të tilla që u sigurojnë viktimave të trafikimit në rastet e duhura, informacion në lidhje me procedurat gjyqësore, asistencës e t'i kushtojnë vëmendje inkurajimit të viktimave për të bashkëpunuar me autoritetet.

⁸ Neni 3, pika a) e Protokollit Kundër Trafikimit të Migrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare

⁹ Neni 6, paragrafi 2 i Protokollit.

Konventa e Këshillit të Evropës për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.¹⁰

Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” është akti më i plotë juridik ndërkombëtar. Kjo Konventë ka veçantitë e saj në krahasim me instrumentat e tjerë ndërkombëtarë të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Përsa i përket fushës së zbatimit të kësaj Konvente ajo mbulon të gjitha llojet e trafikimit, cilëndo qofshin viktimat: burra, gra, fëmijë duke siguruar në këtë mënyre barazinë gjinore. Kjo Konventë është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar që përkufizon termin “viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore” në ndryshim nga instrumentat e tjerë ndërkombëtarë të cilët kufizohen duke i lënë secilit Shtet të çmojë se kush do të quhet viktimë dhe për rrjedhojë të përfitojë mbrojtjen e nevojshme.

Ajo ka për qëllim të parandalojë trafikimin e qenieve njerëzore, të mbrojë viktimat e trafikimit, të ndjekë penalisht trafikantët dhe të nxisë bashkërendimin e masave në nivel kombëtar si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. **Konventa zbatohet për të gjitha format e trafikimit, qofshin ato kombëtare ose përtej kufijve, të lidhura ose jo me krimin e organizuar, të gjithë viktimat e trafikimit (gra, burra dhe fëmijë), të gjitha format e shfrytëzimit (seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri, heqje të organeve).**

Vlera më thelbësore e Konventës është përqendrimi i saj në të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e viktimave. **Konventa e përkufizon trafikimin si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si shkelje të dinjitetit dhe integritetit të qenieve njerëzore.** Kjo do të thotë që organet kombëtare janë përgjegjëse në rast se ato nuk marrin masa për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, për të mbrojtur viktimat dhe për të hetuar me efektivitet rastet e trafikimit.

Konventa e përkufizon trafikimin e qenieve njerëzore si kombinim të tre elementëve:

Si veprim: rekrutim, transportim, transferim, strehim ose marrje të personave;

Si përdorim të mjeteve të caktuara: kërcënim ose përdorim të forcës, ose forma të tjera detyrimi, rrëmbim, mashtrim, gënjim, abuzim kompetencash ose të një pozicioni vulnerabiliteti, dhënie ose marrje të pagesave ose të përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër;

¹⁰ Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006.

Për qëllimin e shfrytëzimit: minimalisht, shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, ose heqjen e organeve.¹¹

Gjithashtu, në kuadër të OSBE-së është miratuar një Plan Veprimi për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore¹² që ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave, mospenalizimin e personave të trafikuar për vepra penale të lidhura me trafikimin, ngritjen e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit dhe hartimin e Udhëzuesve për identifikimin e saktë, informimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve të trafikuar.

1.2 Standardet ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e veprave penale të trafikimit dhe trajtimin e viktimës.

Standardet ndërkombëtare që gjyqtarët duhet të kenë të njohura gjatë gjykimit të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, përmbajnë detyrime për mbrojtjen e viktimave nga trafikimi duke u ndalur tek të miturit në veçanti dhe kërkojnë që në gjykimin e këtyre veprave penale të mbrohen viktimat e të trajtohen ato në përputhje me parimet e humane, të mbrojtjes e garantimit të jetës, shëndetit e personalitetit me qëllim rehabilitimin e tyre.

Ato përbëhen nga norma ndërkombëtare në nivelin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, norma ndërkombëtare të Këshillit të Europës dhe norma ndërkombëtare në nivelin e BE-së, si Vendimet Kuadër, Direktivat dhe Rekomandimet. Këto të fundit nuk janë të detyrueshme por janë të rekomandueshme pasi përcjellin frymën e legjislacionit europian ku dhe ne do aderojmë në të ardhmen e afërt. Përveç dy akteve juridike ndërkombëtarë të përmendura më sipër po rendisim dhe një sërë aktesh të tjera si:

- Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit, miratuar nga Rezoluta 40/34 e nëntorit 1995 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Përkrah përkufizimit të kuptimit “viktimë”¹³ *ky dokument promovon edhe disa të drejta të tyre si veprim deri te organet e drejtësisë dhe trajtim të drejtë ndaj tyre (që mes tjerash nënkupton ndihmën juridike dhe njoftimin në kohë për të gjitha aspektet procedurale), restituim (rikthimi i pronës, kompensimi i dëmit, restorimi i*

¹¹ Neni 4 i Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

¹² Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 557, PC.DEC/557, 24 Korrik 2003, shtojca e Planit të Veprimit, miratuar nga Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 685, PC.DEC/685, 7 Korrik 2005.

¹³ Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.

të drejtave, etj.), kompensim (i siguruar nga shteti kur mjetet financiare të autorit të veprës janë të pamjaftueshme për këtë gjë) etj.

- Konventa e Këshillit të Europës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”¹⁴ nuk rezultoi një normë ndërkombëtare efektive për shkak se ratifikimi i saj nga vendet anëtare të Këshillit të Europës zgjati shumë.
- Privatësia dhe identiteti i personave të trafikuar janë të mbrojtura (Neni 6(1) Prot. i OKB-së për Trafikimin: Neni 11 i Konventës së KE për trafikimin, Neni 17 ICCPR: parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6 & 5(8). Kjo përfshin vendosjen e standardeve për ruajtjen e të dhënave personale dhe inkurajimin e mediave për të mbrojtur jetën private dhe identitetin e viktimave (*Neni 11 i Konventës së KE për Trafikimin*).
- Identiteti i viktimave të trafikimit nuk është i shpalosur publikisht dhe privatësia e tyre respektohet dhe mbrohet me të gjitha mjetet e mundshme, duke marrë në konsideratë të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të drejtë. Personave të trafikuar u jepet një paralajmërim paraprak për vështirësitë që hasen për mbrojtjen e identitetit dhe nuk u jepen pritshmëri false dhe joreale në lidhje me mundësitë e autoriteteve për këtë çështje. (*Parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6.6*).
- Personave të trafikuar u ofrohet këshillim dhe informacion mbi të drejtat e tyre ligjore, mbi procedimet gjyqësore dhe administrative në lidhje me to, në një gjuhë që e kuptojnë si edhe mbi shqetësimet që do të prezantohen dhe konsiderohen gjatë procesit penal (Neni 6 (2) Prot. i OKB për Trafikimin: Neni 12 i Konventës së KE për Trafikimin: Parimet e Rekomanduara të OHCHR Udhëzimi 6 (5): *Deklarat e parimeve bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimi me Pushtetin*, paragrafi 8).
- Personave të trafikuar u jepet asistencë ligjore dhe e llojeve të tjera në lidhje me çdo padi penale apo civile kundrejt trafikuesve (*Parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6(5)*).
- Personave të trafikuar, të cilët merren si dëshmitarë (dhe kur është e nevojshme edhe familjarët), u ofrohet mbrojtje efektive nga dëmtimi, kërcënimet, frikësimet apo hakmarrja e trafikantëve ose e personave të lidhur me ta, gjatë procesit të hetimit dhe të gjyqimit apo në çdo kohë që është e nevojshme për sigurinë e personit. Kjo mund të përfshijë dhënien e dëshmisë në mënyrë që të mbrojtë sigurinë e tyre (p.sh

¹⁴ E hartuar në Strasburg më 24.11.1983 dhe e ratifikuar ngashteti ynë me ligjin nr. 9265 datë 29.07.2004.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

- nëpërmjet komunikimit video) identifikimin e një vendi të sigurt në shtetin e destinacionit: mbrojtjen e identitetit gjatë proceseve ligjore dhe identifikimin e mundësive për qëndrim të vazhdueshëm, risistemimin ose riatdhesimin (*Neni 25 i Prot. të OKB për Trafikimin, neni 28 i Konventës së KE për Trafikimin; Parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6,4.10 & 5.8*).
- Statusi i çdo procedure ligjore të lidhur me viktimën e trafikimit merret në konsideratë në çdo vendim mbi riatdhesimin (*Neni 8(2) i Prot. të OKB për Trafikimin, Neni 16 i Konventës së KE për Trafikimin*).
 - Procedurat ligjore në të cilat personat e trafikuar janë të përfshirë, nuk influencojnë të drejtat, dinjitetin apo mirëqenien e tyre fizike dhe psikologjike (*parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6.4*).
 - Masat marrin në konsideratë moshën, gjininë, dhe nevojat e veçanta të viktimës së trafikimit (*Neni 6(4) i Prot. të OKB për Trafikimin*). Viktimave fëmijë u jepet mbrojtje e veçantë, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës (*Neni 28 i Konventës së KE për Trafikimin*).
 - Si akte Rekomanduese duhet të mbahet parasysh “*Korniza e vendimit të dt.15.03.2001 të Këshillit të BE për pozitën e viktimave në procedimet penale*“, e cila parashikon që «*Shtetet duhet të shqyrtojnë në rast se ligjet dhe procedurat vendase janë të përshtatshme dhe përgjegjëse për viktimat e trafikut, e të inkurajojnë kompesimin e tyre*». Rekomandimi nr.8511 i Komitetit të Ministrave të KE-së «*Për pozicionin e të dëmtuarit në kuadrin e procedurës penale*» parashikon se “një gjykatë penale duhet të urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit nga vepra penale. Duhet të hiqen kufizimet ekzistuese dhe pengesat teknike që çojnë në mosrealizimin e një të drejte të tillë, kompensimi duhet të jetë përparësi në rastin e një dënimi alternativ e se gjykata duhet t’i kushtojë vëmendje nevojës për kompensim të dëmit.
 - Rekomandimi nr.8721 i Komitetit të Ministrave të KE-së «*Mbi ndihmën e viktimave dhe parandalimin e diskriminimit*» shton se *Shtetet duhet të vlerësojnë masën e mbulimit të siguracioneve nga skemat private ose publike të sigurimit për sigurimin efikas të viktimave sipas nevojave të tyre*.
 - Rekomandimi nr.9713 i KE-së «*Në lidhje me kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes*» parashikon gjithashtu se «...masat që duhet të merren për trajtimin e dëshmitarëve veçanërisht në rastet e krimit në

familje».

- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”.

1.3 Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me detyrimin e shteteve për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Rasteve kundër Qipros dhe Rosisë (7 Janar 2010)

Paditësi ishte babai i një vajze të re, e cila vdiq në Qipro ku ajo kishte shkuar për të punuar në Mars të vitit 2001. Ai u ankua se policia qipriote nuk bëri gjithçka që duhej për të mbrojtur vajzën e tij nga trafikimi, kur ajo ende ishte gjallë dhe për të ndëshkuar ata që ishin përgjegjës për vdekjen e saj. Gjithashtu, u ankua për dështimin e autoriteteve Ruse për të hetuar trafikimin e vajzës së tij dhe vdekjen e saj, si dhe për të marrë hapa për ta mbrojtur nga rreziku i trafikimit.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se, si skllavëria, trafikimi i qenieve njerëzore, sipas natyrës dhe qëllimit të shfrytëzimit, bazohet në ushtrimin e pushtetit duke e trajtuar personin si pronë; trajton qeniet njerëzore si mallra që blihen dhe shiten dhe i nënshtrohen punës së detyruar; kjo nënkupton vëzhgimin nga afër të aktiviteteve të viktimave, lëvizjet e të cilëve shpesh ishin të kufizuara; dhe përfshin përdorimin e dhunës dhe kërcënimeve ndaj viktimave. Prandaj, Gjykata u shpreh se Neni 4 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar) ndalon trafikimin. Gjykata konstatoi se Qipro kishte shkelur **detyrimet pozitive që lindin nga neni 4** i Konventës në dy pika:

- I. Së pari, dështimin për të krijuar një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe administrativ për të luftuar trafikimin si rezultat i regjimit ekzistues të vizave për veprimtari artistike.
- II. Së dyti, dështimi i policisë për të marrë masa vepruese për të mbrojtur vajzën e paditësit nga trafikimi, pavarësisht rrethanave që

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

shkaktuan dyshim të besueshëm se ajo mund të kishte qenë viktimë e trafikimit. Gjykata u shpreh se Rusia kishte shkelur **Neni 4** të Konventës për shkak të dështimit për të hetuar se si dhe ku vajza e paditesit ishte rekrutuar dhe veçanërisht, të ndërmarre hapa për të identifikuar ata që u përfshinë në rekrutimin e saj ose metodat e rekrutimit që u përdorën. Më tej Gjykata u shpreh se kishte pasur **shkelje të Nenit 2** (e drejta për jetën) e Konventës nga Qiproja si rezultat i dështimit të autoriteteve Qipriote për të hetuar në mënyrë efektive vdekjen e vajzës së paditesit.

F.A kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr.20658/11)

10 shtator 2013 (*vendimi mbi pranueshmërinë*)

Paditësja, shtetase ganeze, pretendoi se ajo u trafikua në Mbretërinë e Bashkuar dhe u detyrua të ushtrojë prostitucion. Ajo u ankua në veçanti se largimi i saj në Gana do ta rrezikonte atë të binte në duart e trafikantëve të saj të mëparshëm ose në duart e trafikantëve të rinj. Ajo më tej pretendoi se pasi kishte marrë HIV në Mbretërinë e Bashkuar si rezultat i drejtpërdrejtë i trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, shteti kishte detyrimin ta lejonte të qëndronte në Mbretërinë e Bashkuar për t'iu nënshtruar trajtimit mjekësor të nevojshëm.

Gjykata deklaroi si të **papranueshme** kërkesën e paditëses sipas nenit 3 (*ndalimi çnjerëzor ose degradues*) dhe nenit 4 (*ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar*).

Ajo vuri në dukje në veçanti se paditësja mund të kishte ngritur të gjithë ankimimet e saj të Konventës në Gjykatën e Lartë. Duke mos u ankimuar në Gjykatën e Lartë, ajo nuk kishte përmbushur kërkesat e nenit 35 § 1 (kriteret e pranueshmërisë) të Konventës.

L.E kundër Greqisë (nr.71545/12)21 janar 2016

Ky rast lidhet me ankimin e një shtetaseje nigeriane e cila u detyrua të prostituonte në Greqi. Zyrtarisht njohur si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual, paditësja megjithatë u detyrua të priste më shumë se nëntë muaj pasi informoi autoritetet mbi situatën, para se sistemi i drejtësisë t'i jepte atë status. Ajo pretendoi në mënyrë të veçantë se dështimi i Shtetit Grek për t'iu përmbajtur detyrimeve sipas nenit 4 të Konventës (*ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar*) shkaktoi shkelje të kësaj dispozite. Gjykata u shpreh se pati **shkelje të nenit 4** të Konventës

(*ndalimi i skllavërisë dhe i burgosjes, punë të detyruar*). Ajo gjeti në veçanti që efektiviteti i hetimit paraprak dhe hetimet pasuese të rastit ishin komprometuar nga një sërë mangësish. Sa i përket procedurave administrative dhe gjyqësore, Gjykata gjithashtu vuri në dukje vonesa dhe dështime të shumta në lidhje me detyrimet procedurale të Shtetit Grek. Në këtë rast Gjykata gjithashtu vlerësoi se pati **shkelje të Neni 6 § 1** të Konventës (*e drejta për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme*), duke gjetur se kohëzgjatja e procedurës në fjalë ishte e tepruar për një nivel juridiksioni dhe nuk plotësonte kërkesat e "kohës së arsyeshme". Së fundi, Gjykata vendosi se pati **shkelje të nenit 13 Konventës** (*e drejta për zgjidhje efektive*) për shkak të mungesës mbi të drejtën e brendshme të mjetit juridik me të cilin paditësja mund të kishte zbatuar të drejtën e saj për një seancë brenda një kohe të arsyeshme.

J. dhe të tjerët kundër Austrisë (nr.58216/12, 17 janar 2017)

Ky rast lidhet me hetimin e autoriteteve austriake për një pretendim për trafikim personash. Paditësit, dy shtetas filipinas, të cilët kishin shkuar për të punuar si çift në Emiratet e Bashkuara Arabe, pretenduan se punëdhënësit e tyre i kishin marrë pasaportat dhe i shfrytëzonin. Ata thanë se ky trajtim kishte vazhduar gjatë një qëndrimi të shkurtër në Vjenë, ku punëdhënësit e tyre i kishin marrë dhe nga ku përfundimisht arritën të iknin. Pas një kallëzimi ndaj punëdhënësve të tyre në Austri, autoritetet zbuluan se nuk kishin juridiksionin mbi veprat e pretenduara të kryera jashtë vendit dhe vendosën të ndërpresë hetimin në rastin e paditësve lidhur me ngjarjet në Austri. Paditësit pohuan se i ishin nënshtruar punës së detyruar dhe trafikimit të qenieve njerëzore, dhe se autoritetet austriake kishin dështuar për të kryer hetimin e pretendimeve të tyre. Ata argumentuan në veçanti se çfarë kishte ndodhur në Austri nuk mund të shiheshin në izolim, dhe se autoritetet austriake sipas ligjit ndërkombëtar hetonin ngjarjet që kishin ndodhur jashtë vendit.

Gjykata, duke gjetur se autoritetet austriake kishin respektuar detyrën e tyre për të mbrojtur paditësit si viktimat (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore, pohuan se **nuk ka shkelje të nenit 4** të Konventës (*ndalimi i punës së detyruar*) dhe **as të Nenit 3** (*ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues*). Veçanërisht, Gjykata vuri në dukje se nuk kishte asnjë detyrim sipas Konventës për të hetuar rekrutimin e paditësve në Filipine ose shfrytëzimin e supozuar të tyre në Emiratet Arabe, se shtetet nuk janë të detyruara sipas nenit 4 të Konventës të sigurojnë juridiksion universal për veprat penale të trafikimit të kryera jashtë.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Juridiksioni universal mbi veprat penale të trafikimit të kryera jashtë vendit.
Duke u kthyer tek ngjarjet në Austri, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kishin ndërmarrë të gjitha hapat që duheshin në mënyrë të arsyeshme për situatën. Paditësit, të mbështetur nga OJF-ja financuar nga qeveria, intervistuar nga oficerë të trajnuar të policisë iu dha leja e qëndrimit dhe punës për të rregulluar qëndrimin e tyre në Austri, dhe u vendos ndalimi i zbulimit të të dhënave personale për mbrojtjen e tyre. Për më tepër, hetimi i pretendimeve të paditësve për qëndrimin e tyre në Vjenë ishte i mjaftueshëm për vlerësimin rezultativ të autoriteteve, duke pasur parasysh faktet e rastit dhe dëshmitë në dispozicion, ishin të arsyeshme. Çdo hap tjetër në këtë rast - siç është përballur me punëdhënësit e paditësve - nuk ka asnjë shans të arsyeshëm suksesi, pasi nuk ekzistonte marrëveshje e ndihmës së ndërsjelltë juridike midis Austrisë dhe Shqipërisë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, dhe si paditës ishin kthyer vetëm në polici për afërsisht një vit pas ngjarjeve në fjalë, kur punëdhënësit e tyre kishin kohë që kishin dalë jashtë vendit.

Chowdury dhe të tjerët kundër Greqisë (30 Mars 2017)

Paditësit - 42 shtetas nga *Bangladeshi* - u rekrutuan në Athinë dhe në pjesë të tjera të Greqisë nga fundi i vitit 2012 deri në fillim të vitit 2013, pa leje pune greke, për të punuar në fermën kryesore të luleshtrydheve në Manolada. Punëdhënësit e tyre nuk u kishin paguar rrogat dhe i kishin detyruar të punonin në kushte të vështira fizike, nën mbikëqyrjen e rojeve të armatosura. Paditësit pretendonin se i ishin nënshtruar dhunës apo punës së detyrueshme. Ata më tej pretenduan se Shteti ishte i detyruar të parandalonte nënshkrimin e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, të ndërmerre masa parandaluese për këtë qëllim dhe të ndërshkonte punëdhënësit.

Gjykata u shpreh se kishte **shkelje të nenit 4 § 2** të Konventës (ndalimi i Punës së detyruar), duke arsyetuar se paditësit nuk kishin marrë në mbrojtje nga shteti grek. Gjykata vuri në dukje faktin se në veçanti, situata ishte nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe puna e detyruar, dhe specifikonte shfrytëzimin përmes punës si një aspekt i trafikimit të qenieve njerëzore. Gjykata gjeti gjithashtu se shteti kishte dështuar në detyrimet e tij për të parandaluar situatën e trafikimit të qenieve njerëzore në mbrojtje të viktimave, të kryente hetim efektiv për veprat e kryera dhe për të ndëshkuar ata që janë përgjegjës për trafikimin.

L.R kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 49113/09,14 qershor 2011)

Paditësi pretendonte se ishte trafikuar në Mbretërinë e Bashkuar nga Italia nga një shqiptar që e detyroi atë të prostituonte në një klub nate që i merrte të gjitha paratë e fituara. Ajo u arratis dhe filloi të jetonte në një strehë të fshehtë. Ajo pretendoi se largimi i saj nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri do ta ekspozonte atë ndaj rrezikut për t'u trajtuar në kundërshtim me nenin 2 (*e drejta për jetë*), 3 (*ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues*).

Gjykata vendosi ta çrregjistronte kërkesën, në përputhje me nenin 37 të Konventës për shkak se paditësja dhe e bija kishin përfituar statusin e refugjatit në Mbretërinë e Bashkuar dhe nuk ekzistonte më rreziku që ajo të deportohej në Shqipëri. Qeveria gjithashtu kishte vendosur t'i paguante shpenzimet ligjore të kryera nga paditësja.

DH kundër Finlandës (nr.30815 / 09, 28 qershor 2011)

Paditësi, një shtetas somalez i lindur në 1992, arriti me anije në Itali në nëntor 2007. Ai po largohej nga Mogadishu ku pretendonte se ishte detyruar të bashkohej me ushtrinë pas rënies së strukturave administrative të vendit dhe ku ai rrezikoi jetën e tij në duart e trupave etiopiane që synonin kapjen dhe vrasjen e ushtarëve të rinj somalezë. Autoritetet italiane e lanë atë në rrugët e Romës në dimrin e vitit 2007, pa asnjë ndihmë apo burime. Ai ishte vazhdimisht i uritur dhe i ftohtë, abuzuar fizikisht dhe verbalisht në rrugë, dhe nga policia në Milano, ku ai dilte për të kërkuar ndihmë. Përfundimisht, ai u trafikua në Finlandë, ku kërkoi azil që iu refuzua në shkurt të vitit 2010. Paditësi u ankua se nëse kthehej në Itali, ai do të rrezikonte trajtim çnjerëzor ose degradues në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, veçanërisht pasi ai ishte një i mitur i pashoqëruar.

Gjykata e **çregjistroi kërkesën nga lista e saj e rasteve**, në përputhje me Nenin 37 (çregjistrimi i kërkesave) të Konventës, duke arsyetuar se paditësit i ishte dhënë leje qëndrimi e vazhdueshme në Finlandë dhe se ai nuk ishte më subjekt i një urdhëri dëbimi. Gjykata konsideroi kështu se çështja e parashtruar në ankesë ishte zgjidhur.

O.G.O. kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 13950/12)

Paditësja, shtetësja Nigeriane, e cili pretendonte të ishte viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, u ankua se dëbimi i saj në Nigeri do ta ekspozonte në një rrezik real të ritrafikimit. Gjykata **vendosi të çregjistrojë kërkesën nga**

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

lista e saj e rasteve, në përputhje me nenin 37 (çregjistrimi i kërkesave) të Konventës, duke vënë në dukje se paditësja nuk ishte më në rrezik të dëbohej pasi asaj i ishte dhënë statusi i refugjatit dhe leje për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar. Për më tepër, autoritetet Britanike kishin pranuar se ajo kishte qenë viktimë e trafikimit.

Masat e marra nga Shtetet kundër trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Çështjet sipas nenit 8 të Konventës (e drejta për respektimin e privatësisë dhe të jetës familjare).

Kaya kundër Gjermanisë (28 qershor 2007, vendim për pranueshmërinë)

Paditësi, shtetas turk që kishte jetuar në Gjermani për rreth 30 vjet, dënuar në vitin 1999 ndër të tjera për trafikimin e qenieve njerëzore në rrethana rënduese, u dëbua në vitin 2001 nga Gjermania në Turqi pasi kishte shërbyer dy të tretat e dënimit me burg. Gjykatat vendosën se ishte rrezik i madh se ai mund të vijonte të përbënte kërcënim serioz për publikun. Paditësi u ankua se dëbimi i tij nga Gjermania kishte shkelur jetën e tij private dhe familjare. Gjykata u shpreh se nuk kishte **shkelje të nenit 8** (e drejta për respektim të jetës private dhe familjare) të Konventës. Ajo çmoi se dëbimi i paditësit ishte në përputhje me Konventën, veçanërisht duke pasur parasysh se ishte dënuar për vepra të rënda në Gjermani dhe se kishte qenë në gjendje të kthehej në Gjermani.

Raste/Çështjet sipas nenit 1 (mbrojtja e pronës) të Protokollit Nr. 1

Tas kundër Belgjikës (12 maj 2009, vendim mbi pranueshmërinë)

Ky rast lidhet me konfiskimin e objekteve të përdorura në lidhje me veprën penale të lidhur për trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin e të huajve të pambrojtur. Paditësi bazua në neni 1 (mbrojtjen e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Gjykata e shpalli kërkesën si të **papranueshme**, qartazi të pabazuar. Duke marrë parasysh kufirin e vlerësimit që u jepet Shteteve në kontrollin e “përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm“, në veçanti në kontekstin e një politike me qëllim luftimin e aktiviteteve kriminale, gjeti se ndalimi i ushtrimit të së drejtës për të poseduar qetësisht pasurinë nuk ishte joproporcional me qëllimin e ligjshëm të ndjekur, pra, në përputhje

me interesin e përgjithshëm për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin e të huajve në një situatë të pasigurt.

1.4 Koncepti i trafikimit në legjislacionin penal shqiptar.

Legjislacioni ynë penal ka reflektuar frymën e normave ndërkombëtare të cituara sa më sipër duke përmbushur detyrimin e tyre për cilësimin si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore.¹⁵ Edhe këtu është e rëndësishme të kujtohet se detyrimi në Protokollin për Trafikimin për ta cilësuar si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore nuk kërkon që legjislacioni vendas të përdorë të njëjtën mënyrë shprehjeje me përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Në vend të kësaj, është e mira që legjislacioni vendas të përpilohet në një mënyrë që të përputhet me kuadrin ligjor të brendshëm të vendit, me kusht që të përmbajë një ndërthurje të elementeve përbërës që përmban përkufizimi.

Kodi Penal i RSH ka pësuar disa ndryshime në veprat penale të trafikimit¹⁶, por në thelb ai përmban pothuajse *mot a mot* përkufizimin e dhënë nga Protokollin i Palermos dhe Konventa e Varshavës. Kodi ynë penal parashikon si forma të trafikimit të qenieve e njerëzore atë të emigrantëve, femrave për prostitucion dhe si formë më vete atë të trafikimit të të miturve: “*Trafikimi i qenieve njerëzore*“, neni 110/a i KP¹⁷ dhe “*Trafikimi i të miturve*”, neni 128 i KP.

Kështu neni 110/a i Kodit Penal “*Trafikimi i personave*” parashikon:

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

¹⁵ Detyrim që rrjedh nga neni 5 i Protokollit shtesë mbi Trafikimin, pjesë e Konventës së OKB.

¹⁶ Neni 110/a, Trafikimi i personave të rritur (Shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; ndryshuar titull, fjalët në paragrafin e parë dhe paragrafi i tretë dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013).

¹⁷ Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave”, neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i KP.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Nenet vijuese 110/b dhe 110/c¹⁸ kanë penalizuar përfitimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar si dhe veprimet që lehtësojnë trafikimin.¹⁹

Neni 128/b “Trafikimi i të miturve” parashikon se:

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet

¹⁸ Shtuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013. Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. ”Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.”

¹⁹

me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Objekt i përgjithshëm i këtyre dispozitave janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtat dhe liritë e personit nga çdo veprim ose mosveprim kriminal. Objekt i drejtpërdrejtë i kësaj dispozite, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar lirinë e personit, përfshirë lirinë seksuale të tij, të drejtën e personit për të qenë i lirë dhe për të vendosur në mënyrë të vullnetshme mbi jetën e tij dhe veprimet që ai dëshiron të kryejë në raport me subjektet e tjerë të së drejtës, i cili përbën objektin parësor të kësaj vepre penale. Si objekt dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar jetën dhe shëndetin e personit, dinjitetin dhe personalitetin e tij nga çdo veprim ose mosveprim kriminal.

Nga ana objektive, kjo vepër penale kryhet me veprime aktive të kundërligjshme, të cilat konsistojnë detyrimisht në tre elementët e mëposhtëm:

Rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personit.

Rekrutimi i personit, si pjesë e anës objektive të figurës së kësaj vepre penale, ka të bëjë me gjetjen e personave dhe me nënshtrimin e tyre, qoftë me anë të dhunës fizike apo psikike, apo me anë të mashtrimit ose duke përfituar nga gjendja vulnerabël e tyre, etj., me qëllim trafikimin e tyre.

Transportimi i personit, nënkupton zhvendosjen e këtij personi, nga një vend në një vend tjetër, qoftë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, qoftë jashtë këtij territori, me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj vepre penale të kryer në formën e transportimit të personit, nuk ka rëndësi, nëse viktima transportohet me anë të mjeteve të transportit rrugor, ujor, ajror apo hekurudhor. E rëndësishme është që viktima, jashtë vullnetit të saj dhe me qëllim trafikimin e saj, transportohet dhe lëviz nga një vend në tjetrin. Në rastin e zhvendosjes së personit nga një vend në tjetrin, nuk është

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

e nevojshme që personi të ketë hyrë apo të jetë i pranishëm në mënyrë të paligjshme në territorin e një shteti tjetër. Trafikimi ndodh dhe nëse hyrja apo qëndrimi në një shtet tjetër është kryer në mënyrë të rregullt.

Transferimi i personit, me qëllim trafikimin, është një koncept i ngjashëm me transportimin, ku subjekti i veprës penale e transferon një person nga një vend në një vend tjetër, zakonisht jashtë shtetit, me qëllim që ta trafikojë. Transferimi i personit me qëllim trafikimin është një koncept i ngjashëm me transportimin e personit, por jo në çdo rast që kemi transportim të personit kemi edhe transferim të tij nga një vend në tjetrin. Në këtë kontekst, ligji ynë njeh trafikimin e brendshëm sipas së cilit transferimi mjafton të kryhet nga një vend në një tjetër pa patur nevojë të kalojë territorin e shtetit.

Fshehja e personit, nënkupton mbajtjen në mënyrë të fshehtë e të izoluar të personit nga ambjenti i jashtëm dhe moslejimin e kontakteve të tij me mjedisin social, me persona të afërm të familjes apo me persona të tjerë, e bërë kjo, me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj forme të kryerjes së veprës penale, kërkohet detyrimisht, që viktima të privohet nga liria e saj dhe të mbahet e izoluar jashtë vullnetit të saj, duke i hequr çdo mundësi që ajo të komunikojë me persona të tjerë dhe me botën e jashtme.

Pritja e personit, nënkupton, veprime që kryhen nga ana e subjektit të veprës penale, që kanë të bëjnë me pritjen, përcjelljen, strehimin e personit dhe me shoqërimin e tij për në një vend të caktuar, zakonisht banesë ose hotel, me qëllim trafikimin e tij. Kjo formë e veprës penale mund të kryhet në bashkëpunim, ndërmjet dy ose më shumë personave²⁰, ku një prej bashkëpunëtorëve bën “*rekrutimin e personit*”, bashkëpunëtori tjetër bën “*transportimin dhe/ose transferimin e viktimës*”, ndërsa bashkëpunëtori tjetër, bën “*pritjen e viktimës*”.

Në mënyrë që vepra penale të konsiderohet si plotësisht e kryer nga ana e autorit të saj, mjafton që prej tij të kryhet edhe vetëm në një nga format e mësipërme të realizimit të veprës penale, kuptohet, kur ekzistojmë edhe dy elementët e tjerë të anës objektive, të cilët do të trajtohen më poshtë. Kjo do të thotë, se kur plotësohen edhe dy elementët e tjerë të anës objektive të kësaj vepre penale, subjekti do të konsiderohet se e ka kryer në mënyrë të plotë

²⁰ Kryerja e veprës penale në bashkëpunim sipas paragrafeve 2, 3 etj të neneve 110/a është një nga format e shpeshta të kryerjes së saj.

këtë vepër penale, në rastet kur ai ka bërë vetëm rekrutimin e personit, ose vetëm transportimin e personit, ose vetëm transferimin e personit, ose vetëm fshehjen e personit, ose vetëm prитjen e personit, me anë të mashtrimit apo kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e saj/tij, etj. dhe me qëllim trafikimin e tij, pavarësisht se nuk e ka trafikuar këtë person, si dhe pavarësisht se nuk e ka shfrytëzuar këtë person.

Rast praktik: Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në lidhje me veprën penale të trafikimit, arsyeton: ...Gjykata çmon me këtë rast të sqarojë se, vepra penale e “Trafikimit të femrave”, e parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal, është vepër penale formale, domethënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje kriminale, në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kjo vepër, që të konsiderohet e konsumuar, mjafton që të provohen të gjithë elementët e saj, që kanë të bëjnë me objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive dhe nuk kërkon ardhjen e asnjë lloj pasoje... ”.²¹

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, me vendimin e saj nr.47, datë 23.10.2007, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera ka arsyetuar: “...Figura e veprës penale të trafikimit të femrave, konsiderohet e formuar edhe me ekzistencën e njërit nga elementët e saj, kur bëhet në format dhe qëllimet e sipërcituara të kësaj dispozite. Pra, do të mjaftonte edhe vetëm elementi i rekrutimit apo i transportimit etj., nëpërmjet formave dhe qëllimeve të lartpërmendura, që i pandehuri të ketë përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Fakti, që i pandehuri nuk ia arriti qëllimit që t’a shfrytëzojë të dëmtuarën për prostitutë, nuk bën që ai të mos përgjigjet penalisht, pasi ai i ka konsumuar të gjithë elementët e kësaj figure vepre penale... ”.²²

Në reflektim të rekomandimit të Protokollit të Palermos, edhe tek ne nuk është kusht i domosdoshëm ekzistenca e shfrytëzimit, por shfrytëzimi mund të shoqërojë apo pasojë trafikimin ose mund të përbëjë trafikimin në vetvete.

- rekrutimi ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, të bëhet ose me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, ose me

²¹ Vendimi nr.31, datë 14.06.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M www.gjkr.gov.al

²² Vendimi nr.47, datë 23.10.2007, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

anë të rrëmbimit, me anë të mashtrimit, me anë të shpërdorimit të detyrës, me anë të përfitimit nga gjëndja shoqërore e të të dëmtuarit, me anë të përfitimit nga gjëndja fizike apo psikike, me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.

Kjo nënkupton që rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të kërcënimit që i bëhet personit, me qëllim trafikimin e tij, ku kërcënim i personit, nënkupton dhunën psikike ose kanosjen që i bëhet personit.

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përdorimit të forcës, me të cilën kemi parasysh përdorimin e dhunës fizike, që subjekti i veprës penale ushtron ndaj të dëmtuarit. Dhuna fizike, nënkupton dëmtime dhe lëndime fizike, që i bëhen personit si: rrahje, goditje me sende të ndryshme, shtyrje, rrëzim përtokë, deri tek plagosja e lehtë, që i bëhen të dëmtuarit me qëllim trafikimin e tij.

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të formave të tjera të shtrëngimit, me të cilat do të kuptojmë, të gjitha ato veprime, të cilat ndikojnë në mënyrë thelbësore në vullnetin e të të dëmtuarit, duke i hequr atij plotësisht lirinë që të disponojë për veten e tij, të cilat janë të ndryshme nga dhuna fizike apo psikike. Si veprime të tilla, mund të përmendim për shembull: lënien e të dëmtuarit pa ushqim, ose mossigurimi për të dëmtuarin i kushteve minimale të jetesës, higjieno-sanitare ose të fjetjes etj.

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të rrëmbimit. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të mashtrimit, kur subjekti përdor gënjeshtëri ose shpërdoron besimin e të dëmtuarit, me qëllim trafikimin e tij. Për shembull viktimat mund të mashtrohen duke u premtuar se i pret një vend pune tërheqës dhe jo në fakt situata e shfrytëzimit.

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të shpërdorimit të detyrës, kur në

veprimet e subjektit të veprës penale, ekzistojnë të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal²³. I vetmi dallim që ekziston në këtë rast, është fakti se subjekti, veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e kryen me qëllim trafikimin e të të dëmtuarit.

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e viktimës, kur subjekti e kryen veprën penale, duke shfrytëzuar disa nga këto rrethana, që lidhen me të dëmtuarin, gjendja e rëndë ekonomike e të të dëmtuarit, kur i dëmtuari nuk ka asnjë mjet për jetesë, gjendja familjare e të të dëmtuarit, për shembull, e dëmtuara është rritur pa prindërit, ose është rritur me prindër të divorcuar, të cilët kanë ribërë martesë të re, ose e dëmtuara është e divorcuar dhe është e vetme, me ose pa fëmijë të mitur, niveli i ulët arsimor i të dëmtuarit, izolimi nga bota e jashtme që mund të ketë patur i dëmtuari, si pasojë e kushteve të rënda ekonomike ku është rritur, morali shoqëror i një zonë të caktuar, prapambetja intelektuale etj. *Në një rast në gjykim në Gjykatën e Krimve të Rënda, e mitura ishte dhënë për shfrytëzim seksual për një periudhë të caktuar në Greqi me qëllim të shlyerjes së një borxhi që e ëma e saj ia kishte marrë trafikantit e nuk kishte mundur t’ia shlyente.*²⁴

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, *bëhet me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike e të dëmtuarit*, ku me gjëndje të rëndë fizike, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari është i dëmtuar rëndë fizikisht, p.sh: paraplegjik, Me gjëndje të rëndë psikike të të dëmtuarit, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari ka zhvillim të vonuar mendor ose vuan nga sëmundje mendore, të cilat e bëjnë të paaftë për të kuptuar plotësisht veprimet që kryhen në dëm të tij dhe pasojat që vijnë prej tyre.

²³ Neni 248 i Kodit Penal përcakton: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një million lekë”.

²⁴ Vendimi nr. 72 datë 23.10.2008 i Gjykatës së Shkallës së Për për Krime të Rënda, www.gjkr.gov.al.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të dhënies së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, jep një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimit të tij. *Në një rast viktima ishte dhënë për shfrytëzim kundrejt një pagese prej 4000 Euro që autori mori si kundravlehtë.*

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, *bëhet me anë të marrjes së pagesave ose të përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër*, kur subjekti i veprës penale, merr një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit, të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimit të tij.

Në mënyrë që vepra e “*Trafikimit të personave*” të konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë nga ana e subjektit të veprës penale, mjafton të provohet se ai ka përdorur, qoftë edhe një nga format e mësipërme për të realizuar trafikimin e personit. Pra, vepra penale, do të konsiderohet plotësisht e kryer, në qoftë se subjekti, rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave, e ka bërë qoftë edhe vetëm me anë të kërcënimit ose qoftë edhe vetëm me anë të përdorimit të forcës ose qoftë edhe vetëm me anë të formave të tjera të shtrengimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të rrëmbimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të mashtrimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të shpërdorimit të detyrës, ose qoftë edhe vetëm me anë të përfitimit nga gjëndja shoqërore, psikike apo fizike, ose qoftë edhe vetëm me anë të marrjes ose dhënies së pagesave për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.

Në qoftë se rezulton që subjekti e ka kryer veprën në dy ose më shumë prej këtyre formave të trajtuara më lart dhe të parashikuara në dispozitë, ai nuk do të përgjigjet aq herë në sa forma e ka kryer veprën, por do të përgjigjet vetëm një herë dhe fakti që ai e ka kryer veprën me anë të disa prej këtyre formave, tregon për rrezikshmërinë e madhe të tij, fakt që duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

- Rekrutimi ose transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, i bërë me anë të kërcënimit ose me anë

të përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, ose me anë të mashtrimit, ose me anë të shpërdorimit të detyrës ose me anë të përfitimit nga gjëndja shoqërore e të të dëmtuarit, ose me anë të përfitimit nga gjëndja fizike apo psikike, ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, duhet që të bëhet ose me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose me qëllim shfrytëzimin e punës ose shërbimeve të detyruara, ose me qëllim skllavërimin e personit ose formave të ngjashme me të, ose me qëllim vënien në përdorim ose transplantimin e organeve, ose me qëllim të çdo shfrytëzimi tjetër.

Nga sa sipër del që trafikimi kryhet nëpërmjet formave të shfrytëzimit për qëllime prostitucioni, punë të detyruar, shërbime të tjera të detyruara, për transplantim të organeve.

Siç mund të konstatohet secili prej këtyre rasteve të elementit të tretë të anës objektive të figurës së veprës penale është i lidhur me konceptin “Shfrytëzim i të dëmtuarit”. Ky koncept ka kuptimin që në çdo rast i dëmtuari jashtë vullnetit të tij dhe kundër dëshirës së tij, dhe i detyruar nga subjekti i veprës penale, shfrytëzohet, në një nga format e përmendura më lart²⁵. Tek kjo veprë penale në të gjitha format e kryerjes së saj, mungon vullneti i të dëmtuarit në kryerjen e veprimeve, i dëmtuari është totalisht i kontrolluar nga subjekti i veprës penale dhe kryen çdo veprim që i kërkohet prej tij.

Ndikimi që ushtron subjekti i veprës penale tek i dëmtuari, kryhet me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës, ose me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, me anë të mashtrimit, me anë të shpërdorimit të detyrës ose duke përfituar nga gjëndja shoqërore apo fizike ose psikike e të dëmtuarës etj.

Gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprës penale, çdo fitim i nxjerrë nga ana e të dëmtuarit si pasojë e shfrytëzimit të tij, përfitohet, si rregull, nga ana e subjektit të veprës penale. Të dëmtuarit, gjatë kohës së kryerjes së kësaj veprë penale nga ana e subjektit, i është hequr në mënyrë të plotë liria, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ai shndërrohet në një vegël të bindur të subjektit të veprës penale, duke mos pasur fare rëndësi që të kryejë veprime sipas vullnetit të tij, dhe kjo përbën dhe një nga dallimet bazë, ndërmjet veprës penale të “*Trafikimit të personave*” dhe me veprat të “*Ndihma*

²⁵ Forma të cilat janë të parashikuara në mënyrë të shprehur nga neni 110/a i K.Penal.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

*për kalim të paligjshëm të kufijve*²⁶ apo kontrabandimi siç quhet në të drejtën ndërkombëtare.

Në mënyrë që vepra të konsiderohet e kryer, nga ana e subjektit, mjafton që ai ta ketë pasur qëllimin për të kryer atë, qoftë dhe vetëm me anë të një prej formave të shfrytëzimit të parashikuara nga dispozita, pra qoftë edhe me anë të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose qoftë edhe vetëm me anë të shfrytëzimit të punës ose shërbimeve të detyruara, ose qoftë edhe vetëm me anë të skllavërimit të personit ose formave të ngjashme me të, ose qoftë edhe vetëm me vënien në përdorim ose trasplantimin e organeve, ose me çdo shfrytëzimi tjetër.

Në qoftë se subjekti e ka pasur si qëllim për të kryer veprën, në dy ose më shumë prej formave të parashikuara më lart, pra, e ka pasur si qëllim për ta kryer edhe për shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, edhe me anë të shfrytëzimit të punës së detyruar, edhe me anë të vënies në gjendje skllavërie të personit, etj subjekti, nuk do të përgjigjet, aq herë, në sa forma ka pasur si qëllim për të kryer veprën, por vetëm një herë të vetme, ndërsa fakti që ai ka pasur si qëllim për ta kryer veprën, në disa forma tregon për rrezikshmërinë e lartë të tij, dhe ky fakt duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

Për kuptimin e drejtë të veprës penale të “*Trafikimit të personave*”, do të duhet të theksojmë edhe një herë që, në mënyrë që kjo vepër të konsiderohet si plotësisht e kryer, elementi i tretë i saj, qëllimi për shfrytëzim prostitucioni, ose për çdo qëllim tjetër të kundërligjshëm të të dëmtuarit, nuk është e domosdoshme që të realizohet nga subjekti i veprës penale, por mjafton që të provohet qëllimi i subjektit për të shfrytëzuar në mënyrë të kundërligjshme personin e dëmtuar.

Një çështje e diskutueshme në praktikën gjyqësore ka qënë fakti i përfshirjes apo konkurrimit të shfrytëzimit në trafikim dhe nëse është kusht i domosdoshëm i ekzistencës së veprës penale të trafikimit dhe shfrytëzimi. Shfrytëzimi i kundërligjshëm i të dëmtuarit nuk është konsideruar si pjesë e anës objektive të veprës penale të “*Trafikimit të personave*”.

Në një vendim Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në një vendim ²⁷shprehet se „...i pandehuri R.E ka bashkëpunuar me të pandehurin F.S vetëm në shfrytëzimin e prostitucionit të të dëmtuarës M.G në shtetin italian e se

²⁶ Në Protokollin e Palermos kjo vepër penale njihet si emigracioni ilegal ose kontrabandimi i emigrantëve.

²⁷ Vendimin nr. 44 datë 02.07.2012 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

trafikimi është bërë nga i pandehuri tjetër... „duke e ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga trafikim në shfrytëzim prostitucioni, neni 114/a pika 5 e KP. Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ndër të tjera arsyeton se:...Që të konsiderohet e formuar figura e veprës penale të trafikimit të femrave, mjafton që të jetë prezent qoftë edhe njëra nga elementët e saj, pra do të mjaftonte edhe vetëm elementi i rekrutimit apo ai i transportimit apo transferimit apo i fshehjes apo i pritjes së femrës, në një nga format dhe për qëllimin e përcaktuar në dispozitën e lartpërmendur”²⁸

Subjekti i kësaj vepre penale, është i përgjithshëm, pra çdo person që ka arritur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit për veprimet që kryen. Nga ana subjektive, kjo vepër penale, kryhet në çdo rast me dashje direkte dhe me qëllim realizimin e përfitimeve monetare ose pasurore, ose të çdo qëllimi tjetër.

Në mënyrë të veçantë Kodi ynë Penal ndëshkon trafikimin e të miturve sipas nenit 128/b²⁹ duke iu përmbajtur përkufizimit të Konventës për të miturin – fëmijë nënkuptohet çdo person nën 18 vjeç. Në këtë rast kur viktimë është një i mitur - fëmijë elementët e figurës së veprës penale janë të njëjta me ato sa argumentuam më sipër por sanksionet janë më të larta.

Në lidhje me dallimin me dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit ose kontrabandimin e emigrantëve siç cilësohet në legjislacionet e huaja, kemi të bëjme me elementin e vullnetit të personit dhe lidhjen me autorin e kryerjes së veprës penale, me qëllim realizimin në rrugë kriminale të përfitimeve materiale. Kodi Penal (*nenet 297-298*), nuk përdor termin kontrabandimi i personave apo trafikimi i migrantëve, por kriminalizon kalimin e paligjshëm të kufirit apo ndihmën për kalimin e paligjshëm të kufijve. Dallimi qëndron në faktin se në rastin e kalimit të paligjshëm apo dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm emigrantët apo personat kalohen me dëshirën e vullnetin e tyre dhe lidhja me autorët përfundon me kalimin e territorit shqiptar në një vend tjetër kufitar. Ndërsa në rastin e trafikimit, emigranti/femra/ i mituri përdoren si *corpus delicti* për të nxjerrë fitime, transferohen, kalohen jashtë territorit pa dëshirën e vullnetin e tyre ose duke e vesuar atë vullnet dhe lidhja me trafikantin nuk përfundon me kalimin e territorit.

²⁸ Vendimin nr.5 datë 17.01.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, www.gjkr.gov.al.

²⁹ Shtuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; shtuar me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008; ndryshuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013.

1.4.1. Trafikimi i brendshëm sipas Kodit tonë Penal.

Veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, e realizuar kjo nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës, etj.

Përkufizimi i veprës penale të trafikimit jo domosdoshmërisht është i lidhur me kalimin e territorit të RSH. Neni 110/a i KP citon shprehimisht “...si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Sipas frymës së Konventës së Varshavës³⁰ edhe Kodi ynë Penal në përkufizimin e veprës penale të trafikimit nuk pengon ndjekjen penale kur trafikimi ka ndodhur brenda vendit e nuk e lidh atë domosdoshmërisht me kalimin e kufijve shtetërorë. Kjo pasi trafikimi mund të konsumohet brenda territorit të vendit dhe mund të ketë natyrë kombëtare nëpërmjet shfrytëzimit për prostitucion apo punë të detyruar brenda vendit. Format e kryerjes së trafikimit të brendshëm zakonisht janë ato të shfrytëzimit për prostitucion të të miturve brenda vendit ose femrave/të mitura apo të rritura nga pakicat rome kryesisht ose nga grupet shoqërore vulnerabël duke i detyruar të ushtrojnë prostitucion në Tiranë ose në zonat bregdetare gjatë sezoneve turistike.

1.4.2. Dallimi ndërmjet trafikimit të personave të rritur dhe shfrytëzimit të prostitucionit.

Shfrytëzimi i prostitucionit nënkupton shtyrjen e personit, me anë të këshillave, bisedave, udhëzimeve, premtimeve apo mashtrimeve për të ushtruar prostitucion. Ndërmjetësimi realizohet nga persona të ndryshëm, të cilët luajnë rolin e ndërmjetësit midis të dëmtuarit dhe klientit të tij ose marrjes së shpërblimit: nga i dëmtuari ose person tjetër.

Dallimi kryesor mes shfrytëzimit të prostitucionit/neni 114 dhe trafikimit të personave të rritur/neni 110/a kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/të qenit i përgjegjshëm dhe vullneti i lirë për të ushtruar prostitucion. E ndërsa shfrytëzimi për prostitucion në veprën penale të trafikimit bëhet duke e zhveshur viktimën nga vullneti pasi ajo detyrohet të prostitutojë nga shtrëngimi, presioni, mashtrimi, apo kushtet në të cilat ndodhet, kemi veprën penale të shfrytëzimit kur femra pranon vetë me dëshirë

³⁰ Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore“, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006

që të ushtrojë prostitucion. Kufiri i ndarjes në mes të dy formave është i hollë por gjithnjë duhet vërtetuar qënia si e lirë në vullnetin për të ushtruar lirisht e jo e shtrënguar prostitucionin.

Dallimi, ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 dhe nenit 128/b të Kodit Penal, qëndron në faktin se mënyrat/format e realizimit të këtyre dy veprave penale janë të ndryshme (neni 114 parashikon se një person shtyn, ndërmjetëson apo merr shpërblim për shfrytëzimin e një fëmije/të mituri për prostitucion). Në rastin e trafikimit të të miturve, qëllimi i shfrytëzimit është më i gjerë sesa shfrytëzimi vetëm për prostitucion.

Nëse kemi shtytje, ndërmjetësim apo marrje shpërblimi për shfrytëzimin e një të mituri për prostitucion, jemi para një rasti trafikimi të qenieve njerëzore. Në pamje të parë, të krijohet përshtypja, që neni 114 paragrafi i dytë, kriminalizon vetëm pjesën e shfrytëzimit të një të mituri, por kjo nuk do të thotë që i mituri nuk është i trafikuar. Me ndryshimet e vitit 2013, koncepti i ‘trafikimit të brendshëm’ (si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), nuk është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 128/b të Kodit Penal.

Në çdo rast, kur viktima është e mitur, pëlqimi që jep i mituri për të ushtruar prostitucion nuk merret në konsideratë/nuk ka vlerë, pavarësisht faktit nëse është cënuar ose jo vullneti, për shkak të gjendjes vulnerabël ose rrethana të tjera. Konventa e Varshavës, parashikon: “...*Trafikimi i fëmijëve, për çfarëdo lloj forme shfrytëzimi, do të konsiderohet trafikim edhe nëse nuk përdoren mjetet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, pavarësisht vullnetit të fëmijës*”.

1.4.3. Dallimi ndërmjet trafikimit të të miturit nga keqtrajtimi i të miturit (lypja e detyruar apo shfrytëzimi në punë të detyruar).

Kodi ynë penal në lidhje ka përmbledhur tek vepra penale e keqtrajtimit të të miturit edhe keqtrajtimin nga prindërit, familjarët por dhe rastin e detyrimit të fëmijëve për të punuar apo lypur. Në rastin e parë³¹ dallimi kryesor ndërmjet këtyre dy dispozitave trafikimi, neni 128/b, dhe keqtrajtimi i të miturit neni 124/b është subjekti aktiv i veprës penale, që në rastin e veprës penale ‘*keqtrajtimi i të miturit*’ është i posaçëm: prindi, kujdestari ose personi që është përgjegjës për rritjen dhe edukimin e tij. Në rastin e veprës penale “*trafikimi i të miturve*”, subjekti aktiv është i përgjithshëm, por mund të jetë edhe një subjekt i posaçëm – personi që ka për detyrë të kujdeset për të miturin. Ky

³¹ Paragrafi i parë i nenit 124/b të KP: “Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person, që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet”.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

rast i fundit, evidentohet në kryerjen e trafikimit përmes “shitjes së të miturit” si një formë e trafikimit të tyre, që është një veprim i cili në praktikë, është realizuar edhe nga prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor.

Shfytëzimin për punë, shtytjen për të siguruar të ardhura, apo për të lypur Kodi ynë Penal i përfshin sërish tek vepra penale e keqtrajtimit të të miturit pag. 2 i nenit 124/b i cili parashikon se:

“Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja, ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor/ fizik apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”³²

Futja e këtij paragrafi në veprën penale të keqtrajtimit të të miturit duket sikur i lidh këto forma të kryerjes domosdoshmërisht me subjektin e posaçëm që është prindi ose i afërmi i të miturit. Kjo pasi nëse autori i detyrimit për shfrytëzim në punë, punë të detyruar apo lypje është një person tjetër që nuk është prindi ose i afërm i të miturit atëherë kemi veprën penale të trafikimit në njërin nga format e saj. Ky paragraf i futur në këtë nen mund të mos korrespondojë me frymën e normave ndërkombëtare të sipërcituara, të cilat në mënyrë të veçantë mbrojnë interesat e të miturit, pasi këto norma mbrojnë fëmijët nga kryerja e këtyre veprimeve edhe kur ato kryhen nga prindërit. Një problem tjetër është se paragrafi i dytë nuk citon shprehimisht subjektin e posaçëm, mirëpo nëse autori nuk është prindi ose i afërmi në këtë rast kemi formën e veprës penale të trafikimit sipas nenit 128/b të KP:

Legjislacionet e tjera europiane pas miratimit të direktivave të BE³³ në mënyrë që të ndalohen zhvillimet e fundit në lidhje me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, e kryesisht të të miturve e konkretisht shfrytëzimin në punë dhe lypjen e detyruar, kanë adoptuar një koncept më të gjerë të asaj se çfarë duhet konsideruar trafikim i qenieve njerëzore. Krahasuar me vendimin kuadër 2002/629/JHA, Direktiva 2011/36 BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, përfshin forma shtesë të shfrytëzimit. Brenda kontekstit të kësaj direktive, lypja e detyruar duhet kuptuar si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara siç përcaktohet në Konventën e 1930 të ILO, nr.29, në lidhje me Punën e Detyruar, prandaj, shfrytëzimi në lypje, duke përfshirë trafikimin e personit në kujdestari për lypje, përkufizohet si

³² Ky paragraf në nenin 124/b është shtuar me ligjin nr. 144 datë 2.05.2013.

³³ Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrotjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA, Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012.

trafikim i qenieve njerëzore vetëm kur ndodhin të gjithë elementët e punës ose shërbimeve të detyruara. Në dritën e një çështjeje gjyqësore që ka lidhje me një rast të tillë, vlefshmëria e ndonjë pranimi të mundshëm për të kryer një punë apo shërbim të tillë, do të vlerësohet mbi bazën e vlerësimit rast pas rasti.

Megjithatë, kur shqetësimi është për një fëmijë, asnjë pranim i mundshëm nuk duhet të konsiderohet i vlefshëm. Shprehja “*shfrytëzim i të miturit për punë të detyruar ose për të siguruar të ardhura*” duhet kuptuar si shfrytëzim i të miturit në punë apo orare punë në kundërshtim me Kodin e Punës në lidhje me përcaktimin e moshës për të kryer atë punë.

Bibliografi:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, të ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”.
- Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit adaptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006.
- Vendimi Kuadër i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal e datës 15.03.2001,
- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbrojtjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.
- Konventa e Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10 071 datë 9.2.2009
- Kodi i Procedurave Penale të RSH, sipas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.
- Kodi Penal i RSH.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”.

- Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 ”Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndyshuar me ligjin nr. 10 173 datë 22.10.2009 dhe ligjin nr. ligjin nr. 32/2017 datë 30.03.2017.
- The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985). URL: <http://www.unhchr.ch>
- Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997).URL:[www.unhchr](http://www.unhchr.ch)
- Vendime të Gjykatës së Krime të Rënda dhe Gjykatës së Lartë www.gjkr.gov.al
- www.gjykataelarte.gov.al

Prof. Asoc.Dr. Elizabeta Imeraj

Prokurore në Prokurorinë e Krimeve të Rënda

2. NDJEKJA PENALE DHE MËNYRAT E FILLIMIT TË SAJ

2.1 Kallëzimi i bërë nga viktimi e trafikimit.

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit³⁴.

Normat juridiko-procedurale përcaktojnë rregullat mbi bazën e të cilave subjektet procedurale veprojnë duke normuar veprimtarinë e këtyre subjekteve në drejtim të realizimit të veprimtarisë së tyre të përditëshme.

Dispozitat procedurale³⁵ caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit. Dispozitat procedurale penale janë të zbatueshme edhe për të pandehurit e mitur për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm në fuqi. Ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale parashikojnë për të miturin e pandehur ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit, kujdestarit ligjor ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga prokuroria ose gjykata.

Prokurori është subjekti procedural që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Penale³⁶.

Sipas këtij parashikimi ligjor fillimi i një çështjeje penale bëhet në prokurori. Është prokurori personi i cili me marrjen e materialit referues, shqyrton materialin dhe përkatësisht vendos regjistrimin e procedimit penal ose mosregjistrimin e tij, duke disponuar me vendim për mosfillimin e procedimit penal.

Mënyrat e fillimit të ushtrimit të ndjekjes penale në rastet e trafikimit të

³⁴ Neni 1 i Kodit të Procedurës Penale.

³⁵ Neni 2 i Kodit të Procedurës Penale.

³⁶ Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

personave janë nga më të ndryshmet, dhe për një analizë më të detajuar po i ndajmë si më poshtë:

- Kallëzimi i bërë nga viktimat e trafikimit;
- Kallëzimi i bërë nga familjarët e viktimës së trafikimit;
- Kallëzimi i bërë nga persona të tjerë;
- Referimi i bërë nga policia e shtetit;
- Rastet e deportimeve nga shtetet e tjera;
- Materialet e ardhura nga autoritetet ndërkombëtare;
- Kallëzimi i bërë nga OJF-të që asistojnë viktimat e trafikimit.

Sipas kategorizimit të mësipërm, shohim se subjektet të cilat i drejtohen organit procedues me kallëzim janë të ndryshme.

Në rastin e parë, rast në të cilin kallëzimi në organet e ndjekjes penale bëhet nga viktimat e trafikimit, për shkak të dijenisë që ka viktimat e trafikimit në raport me faktet e ndodhura, kjo mund të interpretohet dhe si mënyra më e mirë e fillimit të një hetimi rezultativ.

Megjithatë jo në të gjitha rastet duhet të jemi optimistë, pasi deklaratimet e viktimës së trafikimit duhen analizuar me detaje, por dhe duhen marrë në konsideratë me tendencën për t'u verifikuar në çdo detaj. Kjo për shkak të faktit se viktimat e trafikimit mund të jetë ende nën ndikimin e trafikantit apo në gjendje mendore dhe emocionale të paqëndrueshme.

Viktimat e trafikimit kanë të drejtë të kërkojnë fillimin e ndjekjes penale, dhe mundet t'i drejtohen organit të prokurorisë për të dhënë deklaratime apo dhe policisë gjyqësore. Sipas parashikimeve procedurale³⁷, viktimat ka të drejtë të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit. Me paraqitjen e viktimës së trafikimit në organet përkatëse, është e detyrueshme që asaj t'i bëhen të njohura të drejtat që ajo ka dhe njohja e këtyre të drejtave realizohet kundrejt nënshkrimit të saj në aktin përkatës për marrjen e dijenit. Marrja në pyetje e viktimës së trafikimit konsiston në realizimin e një procedure të kujdeshme ligjore me qëllim marrjen e detajeve të vlefshme dhe të domosdoshme për hetimin.

Gjatë marrjes në pyetje të viktimës së trafikimit, asaj i ofrohet kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera, për të cilat viktimat mund të ketë nevojë.

Me sigurimin e kushteve të përshtatëshme për marrjen në pyetje të viktimës së trafikimit duhet të mbajmë parasysh:

- Vënien e një kontakti psikologjik me viktimën e trafikimit;
- Sigurimin e mbështetjes së viktimës së trafikimit me qëllim krijimin e

³⁷ Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale (Ligji nr 35/2017).

- besimit;
- Trajtimin me dinjitet gjatë procesit të marrjes në pyetje.

Faza e pyetjes së viktimës së trafikimit konsiston në marrjen e të dhënave të vlefshme të cilat synojnë:

- Evidentimin e faktit penal të ndodhur;
- Autorin apo autorët e përfshirë në veprimtarinë kriminale.

Për këtë arsye është e nevojshme që fillimisht viktimja e trafikimit të lihet në tregim të lirë dhe më pas të ndalohet me pyetje konkrete në evidentimin e detajeve. Detajet e nevojshme për t'u kërkuar nuk lidhen vetëm me faktin e prezantuar, por dhe me elementë të tjerë që kanë të bëjnë me:

- Saktësimin e vendeve në të cilat ka ndodhur ngjarja;
- Saktësimin e kohës në të cilën ka ndodhur ngjarja;
- Evidentimin e personave që kanë dijeni;
- Saktësimin e rolit të secilit të autorëve të pretenduar në kallëzimin e bërë;
- Marrjen dijeni për emra konkretë;
- Marrjen e informacionit për lëvizjet e ndryshme brenda dhe jashtë territorit të RSh-së, mënyrës së realizimit dhe mjeteve me të cilat është realizuar lëvizja;
- Marrja e çdo dokumentacioni të paraqitur apo dhe që mundet t'i kërkohej viktimës së trafikimit, dokumentacion të cilin ajo mund ta disponojë;
- Saktësimin e transfertave monetare, nëse ka patur të tilla;
- Saktësimin e objekteve të blera nga autori, nëse ka patur të tilla;
- Dhe detaje të tjera.

Në rastin në të cilin viktimja e trafikimit paraqitet në organin e prokurorisë, është e domosdoshme prania e prokurorit gjatë fazës së marrjes në pyetje. Prania e domosdoshme e prokurorit nuk lidhet vetëm me detaje procedurale, por dhe me faktin e krijimit të një kontakti të drejtëpërdrejtë, qoftë me rastin, qoftë me viktimën e trafikimit.

Në rastin kur viktimja e trafikimit merret në pyetje nga policia gjyqësore në organet e policisë së shtetit para se çështja të referohet në prokurori, oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar me rastin duhet detyrimisht t'i sigurojë viktimës së trafikimit të drejtat e parashikuara proceduralisht.

Organet e ngarkuara për hetimet paraprake³⁸ janë prokurori dhe policia gjyqësore të cilat zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet

³⁸ Neni 277 i Kodit të Procedurës Penale, (Shtuar pika "3" me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002 dhe shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Në kuadër të kësaj realizohet dhe referimi i veprës penale te prokurori³⁹. Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit. Kur ka urgjencë dhe në rastet e krimeve të rënda, njoftimi bëhet menjëherë edhe me gojë, i cili nuk përjashton detyrimin për të referuar me shkrim. Me njoftimin, policia gjyqësore gjithashtu tregon ditën dhe orën në të cilën ka marrë dijeni për veprën penale.

Parashikimet procedurale i lënë hapësirën policisë gjyqësore të kryejë veprime hetimore me iniciativë të saj, veprime këto të cilat më pas referohen në prokurori.

Në rastin në të cilin viktimja e trafikimit merret në pyetje nga policia gjyqësore dhe pasi aktet nisen për në prokurori, prokurori i ngarkuar me çështjen duhet të shohë si domosdoshmëri marrjen në pyetje të viktimës, pavarësisht nga fakti se kjo fazë mundet të jetë kryer nga organet e policisë.

Viktima e trafikimit duhet të ketë mbështetjen e duhur dhe në funksion të faktit që të krijohet qetësia e nevojshme me qëllim ritransmetimin nga ana e saj e ngjarjes së ndodhur.

Nuk është e thënë që marrja në pyetje e viktimës së trafikimit të përfundojë brenda një seancë të vetme. Kjo edhe për shkak të lënies kohë të viktimës së trafikimit në drejtim të kristalizimit të fakteve për të cilat ka dijeni dhe riprodhimit të ngjarjeve të ndodhura asaj.

Rast praktik: Në çështjen K. Ç kundër A. Ç, edhe pse ndjekja penale filloi me kallëzimin e viktimës së trafikimit dhe madje gjatë fazës së hetimeve paraprake u operua me sigurimin e provës për thëniet e viktimës së trafikimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë nuk e gjeti fajtor të pandehurin A.Ç duke e shpallur atë të pafajshëm. Arsyetimi i gjykatës në lidhje me vendimarrjen e saj për pafajësinë, lidhej kryesisht me detaje të dhëna në mënyrë të gabuar përse i përket kohës dhe vendeve nga viktimja e trafikimit gjatë pyetjes së saj me sigurim prove.

³⁹ Neni 293 i Kodit të Procedurës Penale, (Ndryshuar fjalia e parë në pikën 1 dhe shtuar fjalitë në pikën 1 dhe 3 meligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

Në vendimin e saj të datës 09.12.2011 gjykata arsyeton se: “Gjykata, nga analiza e provave që u shqyrtuan në këtë gjykim, ndryshe nga sa pretendon akuza, konstaton se dëshmia e dhënë nga e dëmtuara K. C, nuk konfirmohet, madje në disa prej këtyre provave deklaratimet e saj janë haptazi të pa vërteta sepse:

Sipas deklaratimeve të saj, i pandehuri ka blerë shtëpinë në Rrugën “Don Bosko”, me paratë e saj, të fituara si punëtore seksi në Romë, pas kthimit të tyre, në Shqipëri, pra rreth muajve Shtator-Nëntor 1997, ndërsa sipas Kontratës së shit-blerjes së apartamentit me nr.X Rep, nr. Y Kol, provohet se i pandehuri këtë shtëpi e ka blerë në datë 24.02.1997.

Arsyetimi i përdorur nga Gjykata në lidhje me mosrakordimin e saktë të kohës, qoftë dhe me një ngatërrësë në muaj, e ka bërë dëshminë e viktimës së trafikimit të vlerësohet si e pavërtetë. Ky rast përfaqëson rastin më të volitshëm nga i cili rrjesh si domosdoshmëri marrja e detajeve në mënyrë të saktë.

Në vendimarrjen e saj gjykata arsyeton se:

...Pra verifikimet e bëra nga akuza që në fazën e hetimeve paraprake, jo vetëm nuk konfirmojnë deklaratimet e kallzueses K, por edhe tregojnë pavërtetësinë e këtyre deklaratimeve të saj...

Rasti i prezantuar sa më sipër merret në shqyrtim edhe për shkak të një specifike tjetër që lidhet me faktin se shtetësja viktimë trafikimi K.Ç, është pyetur si dëshmitare që në fazën e hetimeve paraprake, duke konkluduar me sigurim prove në përputhje me nenin 316 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Pavarësisht rëndësisë së përdorimit të sigurimit të provës në raste të tilla, në rastin konkret mungesa e një kontakti të drejtëpërdrejtë mes viktimës dhe trupit gjykues, e ka shtyrë këtë të fundit t’i bëjë një lexim të thjeshtë dëshmisë së saj. Mungesa e një kontakti të drejtëpërdrejtë me viktimën e trafikimit, ka sjellë rezultat në krijimin e bindjes së brendshme të gjykatës, e cila i ka konsideruar të pavërteta thëniet e viktimës duke konkluduar me pafajësi, periudhën disa vjeçare të trafikimit të viktimës nga i pandehuri A.Ç.

2.2 Marrja dijani për veprën penale nga familjarët e viktimës së trafikimit.

Në rastin në të cilin ndjekja penale fillon me kallëzimin e bërë nga familjarët e viktimës së trafikimit mbahen parasysh sa u tha më sipër, duke marrë si bazë burimin e marrjes së informacionit në raport me ngjarjen e ndodhur nga familjarët e viktimës së trafikimit.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Në rastet e hetuara ka rastisur që këto lloj hetimesh të filluara në këtë mënyrë përfaqësojnë jo vetëm një hetim të vështirë, por dhe mundet të jenë rezultat i hamendësimit të prindërve për destinacionin e fëmijëve të tyre, të cilët janë larguar në mënyrë të papritur dhe të paditur nga banesa e tyre. Shumica e rasteve në praktikë fillojnë me shqetësimin e familjarëve për largimin nga banesa duke i shtuar shqetësimin të tyre dhe frikën që mundet të shfrytëzohen apo të trafikohen. Megjithatë ka dhe raste të tjera në të cilat familjarët kanë marrë dijeni në forma të ndryshme në lidhje me trafikimin e mundshëm të familjarit të tyre. Rasti në të cilin, familjarët marrin informacion në lidhje me atë se çfarë po ndodh nga vetë viktimat e trafikimit nëpërmjet një telefonate, një letre apo shkëmbimit të informacionit në ndonjë mënyrë tjetër është shumë i vlefshëm për hetimin.

Gjatë marrjes në pyetje të familjarëve të viktimës së trafikimit duhen mbajtur parasysh saktësimi i detajeve sa më poshtë:

- Marrja dijeni për atë çfarë ka ndodhur;
- Personat e shoqëruar me viktimën e trafikimit;
- Numrat telefonikë të përdorur nga viktimat e trafikimit;
- Vendet e frekuentuara nga viktimat e trafikimit.

Për ilustrim të situatës së mësipërme shërben rasti i gjykuar⁴⁰ nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, çështja penale në ngarkim të L. M, K. Ç dhe B. S për ngjarjen e ndodhur në dëm të shtetasës të mitur A. F.

Rast praktik....Në Vitin 2014, A. F, e mitur u njoh dhe krijoi marrëdhënie dashurore me K. Ç, banues në të njëjtin qytet. Mbi kërcënimin e tij se do t'i shkatërronte familjen, për disa muaj me rradhë, ajo kreu marrëdhënie seksuale, kundrejt pagesës, me persona të ndryshëm. Marrëdhëniet seksuale u kryhen në shtëpitë e gjetura nga K. Ç në bashkëpunim me B. S, i cili gjithashtu merrte përfitime nga A. F. Pas disa muaj të kryerjes së marrëdhënieve seksuale kundrejt pagesës, K. Ç e prezantoi A.F me L. M, duke e gënjer me se bepin e një fejeje me djalin e L.M-së. Pas takimit me L. M, ky i fundit arriti ta bindë të miturën duke e dërguar jashtë shtetit me qëllim shfrytëzimin e saj për prostitucion. E mitura u largua nga banesa pa i lajmëruar prindërit dhe as familjarët e saj. Në lidhje me ngjarjen e ndodhur familjarët e të miturës u paraqitën në Komisariat ku bënë kallëzim për largimin e të miturës nga banesa, duke manifestuar frikën e tyre që ajo mundej të shfrytëzohej apo të

⁴⁰ Vendimi i datës 08.11.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me të cilin janë deklaruar fajtorë shtetasit K.Ç dhe B.S duke u dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

trafikohej.

Kallëzimi i bërë nga familjarët e të dëmtuarës shërbeu për fillimin e ndjekjes penale nga ku më tej u siguruan provat e nevojshme dhe me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, u gjetën fajtorë për veprën penale të kryer në dëm të të miturës A.F, të pandehurit L. M, K. Ç dhe B. S.

Në arsyetimin e saj Gjykata shprehet:

...Duke vlerësuar deklarinimet e të dëmtuarës si të vërteta dhe me fuqi të plotë provuese, gjykata, në çmuarjen në tërësi të provave, vlerëson si të pavërteta deklarinimet e Xh. D, sipas të cilës nuk kishte dijeni për lidhjet e të dëmtuarës dhe për vendodhjen e saj si dhe, deklarinimet e dy të pandehurve që mohuan përfshirjen e tyre në krim.

Mbi bazën e konkluzionit të arritur dhe vlerësimeve të mësipërme, gjykata çmon të pabazuar pretendimet dhe kërkesat e mbrojtësve për paprovueshmëri të akuzës në ngarkim të të pandehurve dhe për ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale.....

2.3 Marrja dijeni për veprën penale nga persona të tjerë.

Kallëzimi i bërë nga persona të tjerë, të cilët nuk janë as familjarë të viktimës së trafikimit dhe as vetë viktima e trafikimit mundet të shërbejë si bazë për fillimin e ndjekjes penale. Normalisht në një situatë të tillë organi procedues duhet të marrë parasysh të dhënat se nga buron informacioni i kallëzuesit. Është detyrë e organeve të hetimit të marrin dijeni në lidhje me çdo person tjetër që rezulton nga deklarinimet e kallëzuesit dhe nga detaje të tjera që dalin nga hetimi i rastit.

Çdo person⁴¹ që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194 të Kodit të Procedurës Penale. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

⁴¹ Neni 283, Kallëzimi nga ana e shtetasve, (ndryshuar numri dhe shtuar fjalia në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Policia gjyqësore⁴² merr të dhëna nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit. Gjatë marrjes së deklarimeve mbahet parasysh zbatimi i procedurave të përcaktuara në nenet 155 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Çdo person ka zotësi për të dëshmuar, me përjashtim të atyre që për shkak të të metave mendore ose fizike nuk janë në gjendje të dëshmojnë. Prania e të metave mendore ose fizike duhet të konfirmohet dhe të vertëtohet. Kur për vlerësimin e thënieve është i nevojshëm verifikimi i aftësive fizike ose mendore për të bërë dëshmi, gjykata edhe kryesisht mund të urdhërojë verifikimet përkatëse.

Nuk mund të pyeten si dëshmitarë⁴³:

- a) personat që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt;
- b) të pandehurit në një vepër penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur, kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të procedimit, i pushimit të akuzës ose çështjes, ose i dënimit, duke përfshirë edhe rastet e gjykimit me marrëveshje dhe të urdhrit penal të dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë;
- c) ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit ose të prokurorit;
- ç) i padituri civil dhe personi civilisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga i pandehuri.

Në parashikimet e reja procedurale pasqyrohet se për bashkëpunëtorin e drejtësisë, gjen zbatim rregullimi ligjor i pyetjes së tij në çdo rast në cilësinë e dëshmitarit.

Bashkëpunëtori i drejtësisë⁴⁴ pyetet në cilësinë e dëshmitarit. Në rast se bën deklarime ose dëshmi të rreme, ai mban përgjegjësi penale sipas ligjit. Thëniet e bashkëpunëtorit të drejtësisë vlerësohen sipas kriterëve që përcaktojnë dispozitat procedurale.

Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri⁴⁵ në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Nëse të dhënat duhet të merren nga një i mitur, duhet të sigurohet prania e prindit ose kujdestarit,

⁴² Neni 297, (Shtuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

⁴³ Neni 156 i Kodit të Procedurës Penale. (Papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

⁴⁴ Neni 36/ai Kodit të Procedurës Penale, Deklarimet e bashkëpunëtorit të drejtësisë. (Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

⁴⁵ Neni 152/3 i Kodit të Procedurës Penale.

ose e një personi të rritur, të zgjedhur nga i mituri, si dhe prania e psikologut.

2.4 Fillimi i ndjekjes penale pas referimit të bërë nga policia e shtetit.

Rasti më i shpeshtë i hasur në praktikë për kryerjen e këtyre hetimeve është referimi i bërë nga policia e shtetit. Organet e policisë së shtetit në bazë të informacioneve që ata kanë mundet që pasi të kryejnë disa veprime me iniciativë të referojnë në prokurori veprën penale. Në bazë të akteve të ardhura dhe informacioneve të marra nga policia e shtetit prokurori mundet të hartojë planin e hetimit duke përcaktuar dhe teknikat e hetimit. Në rastin e marrjes së informacioneve nga policia e shtetit shfrytëzohen të dhënat e ndryshme duke përdorur mjetet për kërkimin e provës dhe konkretisht këqyrjet, kontrollet, sekuestrimet dhe përgjimet.

Rastet dhe format e këqyrjes dhe mënyra e realizimit të tyre janë të përcaktuara në rregullimet procedurale. Këqyrja⁴⁶ e personave, e vendeve dhe e sendeve vendoset nga organi procedues kur është e nevojshme të zbulohen gjurmët dhe pasojat e tjera materiale të veprës penale. Kur vepra penale nuk ka lënë gjurmë ose pasoja materiale ose kur këto janë zhdukur, kanë humbur, janë ndryshuar a lëvizur, organi procedues përshkruan gjendjen dhe kur është e mundur, verifikon se si ka qenë ajo para ndryshimeve, si dhe merr masa që të saktësojë mënyrën, kohën dhe shkaqet e ndryshimeve që mund të kenë ndodhur. Organi procedues mund të urdhërojë fotografime, filmime dhe çdo veprim tjetër teknik.

Në rastin e hetimit të veprave penale që lidhen me trafikimin lind e nevojshme realizmi i këqyrjes së vendeve, sendeve apo dhe dokumentacionit. Si pasojë e realizimit të këqyrjeve mundet të sigurojmë të dhëna të vlefshme për hetimin të cilat burojnë nga këqyrja e sistemit TIMS, që përfaqëson këqyrjen e sistemit të administrimit të të dhënave me qëllim evidentimin e hyrjeve dhe daljeve për dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë për viktimën e trafikimit apo dhe persona të dyshuar që mundet të kenë udhëtuar me të.

Një element i rëndësishëm i këqyrjeve është dhe këqyrja e dokumentacionit pranë bankave, agjencive të dërgimit të parave etj. Nëpërmjet tyre arrihet të evidentohen pasja e dërgesave monetare që mundet të jenë bërë nga viktimat e trafikimit.

Kur ka arsye të bazuara⁴⁷ për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale

⁴⁶ Neni 298 i Kodit të Procedurës Penale.

⁴⁷ Neni 202 i Kodit të Procedurës Penale, kushtet për kryerjen e kontrolleve (ndryshuar numri “299” në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

gjykata merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose banesës. Gjykata që ka nxjerrë vendimin mund të veprojë vetë ose të urdhërojë që veprimi të kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore, të caktuar në vendimin e kontrollit. Në rast flagrante ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontroll, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298 të Kodit të Procedurës Penale.

Kryerja e kontrollit realizohet me qëllim sigurimin e provave konkrete për të cilat ka dyshim që gjenden gjatë kontrollit. Sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen⁴⁸, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit. Sende të tjera të gjetura gjatë kontrollit, që nuk përfshihen në vendimin përkatës, por që lidhen me të njëjtën veprë penale, mund të sekuestrohen duke respektuar dispozitat për sekuestrimet. Kur gjatë kontrollit zbulohen sende që nuk kanë lidhje me veprën penale për të cilat është dhënë vendimi i kontrollit, por që lidhen me një veprë tjetër penale që ndiqet kryesisht, sendet e zbuluara sekuestrohen.

Në hetimin e këtyre veprave penale një rol të rëndësishëm kanë dhe sekuestrimet, pasi mundet të sigurohen të dhëna shumë të vlefshme për hetimin.

Gjyqtari ose prokurori⁴⁹ disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit.

Kodi i Procedurës Penale parashikon disa lloj sekuestrimesh si:

- Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike⁵⁰
- Sekuestrimi i korrespondencës⁵¹
- Sekuestrimi pranë bankave
- Sekuestrimi në zyrat e shërbimeve informative⁵²

Përgjimet në rastin e hetimit të veprave penale që lidhen me trafikimin përfaqësojnë një mjet shumë të rëndësishëm për kërkimin e provës. Nëpërmjet

⁴⁸ Neni 207 i Kodit të Procedurës Penale, sekuestrimi gjatë kontrollit (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

⁴⁹ Neni 208 i Kodit të Procedurës Penale, Objekti i sekuestrimit (ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

⁵⁰ Neni 208/a i Kodit të Procedurës Penale. (shtuar me ligjin nr.10 054, datë 29.12.2008; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

⁵¹ Neni 209 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵² Neni 211/a i Kodit të Procedurës Penale (ligji 35/2017).

tyre mundet të sigurohen të dhëna në lidhje me:

- Vendin në të cilin zhvillohet ngjarja,
- Personat e përfshirë në të,
- Veprimtaria e personave të përfshirë.

Përgjimi i komunikimeve⁵³ të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, lejohen vetëm kur procedohet:

- a. për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet;
- b. për çdo vepër penale me dashje kur kryhet me anën e mjeteve të telekomunikimit apo përdorimit të teknologjive informatike ose telematike.
- c. për veprat penale të parashikuara nga shkronja “a”, paragrafi 1, i nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale. Regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes lejohen vetëm kur procedohet për vepra të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se tre vjet.

Përgjimi mund të urdhërohet kundër:

- a) të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale;
- b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari;
- c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin;
- ç) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit.

Rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit. Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si prove.

Rastet e hetimit të veprave penale që lidhen me trafikimin duke përdorur përgjimet si mjet i kërkimit të provës janë të shpeshta. Në hetimet e kryera haset qoftë përgjimi i komunikimeve telefonike ashtu dhe përgjimi i bisedave ambientale. Rezultatet e përfutuara në të gjitha rastet kanë qënë të vlefshme për hetimin. Në rastin e çështjes me të pandehur A. L, Gjykata e Shkallës

⁵³ Neni 221 i Kodit të Procedurës Penale, kufijtë e lejimit, (ndryshuar me ligjin nr.9187, datë 12.2.2004; ndryshuar shkronja “b” e pikës 1 dhe pika 2 e shtuar shkronja “c” në pikën 1, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

së Parë për Krime të Rënda, Tiranë⁵⁴, gjeti fajtores të pandehurën A.L duke e mbështetur arsyetimin e saj kryesisht në të dhënat e përfutuara nga përgjimet e realizuara.

Gjykata arsyeton se *‘bazuar në aktet dhe provat e shqyrtuara rezultoi e provuar që, e pandehura A. L, ka jetuar në qytetin e Shkodrës, ku gjatë periudhës kohore nga fundi i vitit 2013, e deri në momnetin e arrestimit të saj, ka rekrutuar me qëllim shfrytëzimin si prostituta, vajza të ndryshme, të cilat afroheshin tek e pandehura, me qëllimin e gjetjes së një pune si kamarriere. E pandehura A. L pasi realizonte marrjen me qera të lokalit, kujdesej që në këto lokale të gjente dhe punëtore, si kamarriere. Kryesisht e pandehura rekrutonte punëtore femra të cilat me pas i detyronte të kryenin marrredhenie seksuale, kundrejt pagesës me persona të ndryshëm, të cilët i gjente vetë e pandehura’*. Në vendimarrjen e saj gjykata arsyeton dhe elementët që bëjnë të mundur trafikimin siç është gjendja shoqërore e viktimës së trafikimit, ku shprehet:

“Kur flasim për gjendje shoqërore të të dëmtuarës, këtë term duhet ta interpretojmë, në mënyrë të gjerë dhe duhet të kemi parasysh këto rrethana:

- *gjendja e rëndë ekonomike e të dëmtuarës, ku e dëmtuara nuk ka asnjë mjet për jetesë;*
- *gjendja e keqe familjare e të dëmtuarës, për shembull, e dëmtuara është rritur pa prindërit, ose është rritur me prindër të divorcuar, të cilët kanë ribërë martesë të re, ose e dëmtuara është e divorcuar dhe është e vetme me ose pa fëmijë të mitur etj;*
- *niveli i ulët arsimor i të dëmtuarës;*
- *izolimi nga bota e jashtme që mund të ketë patur e dëmtuara, si pasojë e kushteve të rënda ekonomike ku është rritur;*
- *mentaliteti dhe traditat, në disa raste të disfavorshme, ku është rritur e dëmtuara, etj.*

Në një rast të tillë, autori i veprës penale, duke shfrytëzuar një ose disa nga rrethanat e mësipërme, bën trafikimin e të dëmtuarës. Duke iu referuar praktikës gjyqësore, edhe kjo formë, është një nga format më të shpeshta të kryerjes së veprës penale nga të pandehurit, të cilët duke përfutur nga pozita shoqërore vulnerabël e të dëmtuarës, si për shembull: qenia e saj e divorcuar, me fëmijë të mitur, e braktisur nga familja ose në gjendje të vështirë ekonomike, arrijnë të realizojnë trafikimin e saj’.

Detajet që lidhen me gjendjen shoqërore të të dëmtuarës apo viktimës së trafikimit në rastin konkret kanë dalë në pah si rezultat i përgjimeve të realizuara nga ku krijohet qartë tabloja e mënyrës së jetesës së viktimës së trafikimit, gënjeshtër e bërë asaj për punësimin si kamarriere dhe në fund

⁵⁴ Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë i datës 16.06.2015 me të pandehur A.L.

shfrytëzimi i saj seksual me qëllim realizimin e përfitimeve monetare.

2.5 Marrja dijani për veprën penale si rezultat i deportimit të viktimës së trafikimit.

Rastet e deportimeve apo kthimit nga shtetet e tjera, të viktimave të trafikimit janë të shpeshta. Në raste të tilla veprimtaria që kryhet nga forcat e policisë është shumë e rëndësishme. Janë forcat e policisë ato të cilat kanë kontaktin e parë me viktimën e trafikimit, e cila në disa raste mundet të deportohet dhe me dokumentacion shoqëruar në të cilin shpjegohet arsyeja e deportimit.

Faza e parë në një rast të tillë pas mbërritjes së viktimës është intervistimi i saj nga policia. Në çdo rast shihet e nevojshme kontaktimi me prokurorinë. Për arsye të ndryshme apo dhe për shkak të gjendjes psikologjike të viktimës së trafikimit, mundet që intervistimi të jetë i duhur në një fazë të mëvonshme. Fillimisht viktimës së trafikimit i jepet ndihma e duhur, në kuadër të ndihmës për trajtimin psikologjik, por dhe akomodimi i viktimës në qendrat pritëse, me qëllim krijimin e një atmosfere sa më të mirë për të krijuar besim tek viktima e trafikimit. Megjithatë roli i policisë gjyqësore në rastin e deportimit të viktimës së trafikimit mbetet shumë i rëndësishëm.

Një moment i rëndësishëm procedural është dokumentimi i veprimeve të policisë gjyqësore⁵⁵. Policia gjyqësore dokumenton, qoftë edhe në formë të përmbledhur, të gjitha veprimet e kryera prej saj. Në çdo rast përpilimi i akteve në të cilat dokumentohen veprimet e kryera duhet bërë sipas normave procedurale në mënyrë që aktet të jenë të vlefshme dhe të përdorshme.

Policia gjyqësore mban procesverbal për:

- a) kallëzimet dhe ankimet e paraqitura me gojë;
- b) të dhënat përmbledhëse dhe deklaratimet e marra nga personi, ndaj të cilit zhvillohen hetimet;
- c) të dhënat e marra nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit;
- ç) këqyrjet, njohjet, kontrollimet dhe sekuestrimet;
- d) aktet për identifikimin dhe njohjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, për marrjen e plikove ose të korrespondencës dhe për vënien e sekuestros;
- e) veprimet hetimore të deleguara nga prokurori.

Dokumentacioni i veprimeve të policisë gjyqësore, provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale vihen në dispozicion të prokurorit.

⁵⁵ Neni 303 i Kodit të Procedurës Penale.

2.6 Marrja dijani për veprën penale nga materialet e ardhura autoritetet nderkombëtare.

Sipas rregullave procedurale autoritetet e huaja kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për ndihmë juridike autoriteteve shqiptare të drejtësisë. Ministria e Drejtësisë⁵⁶ vendos që t'i jepet rrugë letërporosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurinë ose interesa të rëndësishme të shtetit. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letërporosinë.

Për shkak të natyrës që kanë veprat penale që lidhen me trafikimin, sidomos në rastet në të cilat trafikimi është kryer jashtë territorit të shtetit shqiptar, ushtrimi i ndjekjes penale në funksion të mbledhjes së provave është e nevojshme të bëhet dhe në bashkëpunim me autoritetet e huaja dhe konkretisht me autoritetet e shtetit në të cilin është trafikuar viktima e trafikimit.

Fillimi i ndjekjes penale mundet të realizohet dhe nëpërmjet akteve që vijnë nga autoritetet e huaja me anë të letërporosisë.

Në rastet në të cilat ka një kërkesë për ndihmë juridike nga autoritetet e huaja, kjo kërkesë nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet. Prokurori i rrethit, pasi merr aktet nga Ministria e Drejtësisë, paraqet kërkesën në gjykatë brenda 5 ditëve nga paraqitja e akteve nga Ministria e Drejtësisë. Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Gjykata që pranon kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë, kryen dhe veprimin e kërkuar ose autorizon për këtë qëllim prokurorin, në rastet kur ligji e lejon. Për kryerjen e veprimeve të kërkuara zbatohen normat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar.

⁵⁶ Neni 505 i Kodit të Procedurës Penale.

Prof. Dr. Aurela Anastasi

3. TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË PROCESIN PENAL (neni 58, 58/b të Kodit të Procedurës Penale).

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (KPP) të sanksionuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, kanë sjellë një kthesë rrënjësore për statusin e viktimave të veprës penale. Në ndryshim nga pozita e mëparshme, tashmë viktimat e veprës penale është palë në procesin penal dhe ka të drejta procedurale që i japin asaj një rol aktiv në këtë proces. Ky është një ndryshim thelbësor që e dallon pozitën e saj, nga pozita pasive e mëparshme. Dikur ajo mund të ushtronte vetëm statusin e dëshmitares, denoncueses ose paditëses civile për kërkimin e dëmit të ardhur nga vepra penale. Aktualisht, ka një sërë të drejtash procedurale. Krahas të drejtave që parashikohen rishtazi për viktimat e veprës penale në përgjithësi (neni 58), viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë edhe të drejta të parashikuara posaçërisht për to (58/b).

Për sa më sipër, është e rëndësishme që këto të drejta të njihen dhe të kuptohen qartë nga të gjithë profesionistët e sistemit të drejtësisë. Prandaj, në këtë punim kemi për qëllim të trajtojmë rrishtazi e ndryshimeve të KPP në lidhje me statusin viktimës e në veçanti, të viktimës së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, me qëllim njohjen dhe zbatimin me efikasitet të tyre nga profesionistët e drejtësisë gjatë procesit penal.

3.1 Klasifikimi i të drejtave të viktimës në procesin penal.

Një klasifikim i të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në procesin penal është i nevojshëm për të kuptuar thellësisht përmbajtjen e tyre. Ai na ndihmon për të identifikuar raportet që vendosen midis viktimës dhe procesit penal, të drejtave të saj gjatë këtij procesi, si dhe përjasjen e këtyre të fundit me të drejtat që burojnë nga aktet ndërkombëtare.

3.1.1 Klasifikimi sipas përkatësisë së tyre.

Nisur nga karakteri dhe përkatësia e tyre, të drejtat procedurale të viktimave mund t'i ndajmë në dy grupe të mëdha: *të drejtat e viktimës në kuptimin e përgjithshëm dhe të drejtat e viktimës në kuptimin e posaçëm*. Kjo ndarje ka rëndësi për t'i njohur këto të drejta në raport me subjektet që i gëzojnë ato. Në vijim do të analizojmë këto kuptime, duke u bazuar edhe në standartet ndërkombëtare të mbrojtjes së viktimave.

3.2 Të drejtat e viktimës në kuptimin e përgjithshëm.

Kur flasim për grupin e parë, theksojmë se ato janë garanci procedurale të vendosura për të respektuar të drejtat në proces për të gjitha viktimat e veprave penale, pra për viktimën si subjekt i përgjithshëm, pavarësisht nga kategoria e veprës penale viktimë e të cilës ajo është. Këto të drejta sanksionohen shprehimisht në nenin 58 të KPP dhe viktimat (përfaqësuesi i saj), mund t'i ushtrojë gjatë gjithë procesit.

Grupin e të drejtave në kuptimin e përgjithshëm, nisur nga përmbajtja e tyre dhe e garancive që ato afrojnë në proces, duhet ta analizojmë bazuar në standardet e vendosura nga aktet ndërkombëtare, veçanërisht nga aktet që vijojnë:

- Rekomandimi (85) 11 për Pozicionin e Viktimës në Kuadrin e të Drejtës dhe Procedurës Penale (Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës 1985)
- Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe Abuzimit të Kompetencave (1985)
- Konventa Evropiane për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (e Këshillit të Evropës, 2005)
- Direktiva “2012/29/EU” e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (25 tetor 2012)

Për sa më sipër, të drejtat në kuptimin e përgjithshëm, të sanksionuara rishtazi në Kodin e Procedurës Penale mund të klasifikohen në këto nëngrupe⁵⁷:

- Të drejtat e viktimës për informim dhe mbështetje;
- Të drejtat e viktimës për të marrë pjesë në procesin penal;
- Të drejtat që lidhen me mbrojtjen e viktimave.

Sidoqoftë, një klasifikim i tillë ka nevojë të studiohet duke mbajtur parasysh faktin se, kufijtë midis këtyre grupimeve nuk kanë një ndarje të prerë, pasi të drejtat zbatohen në bashkëveprim me njëra-tjetrën.

3.2.1. Të drejtat e viktimës për informim dhe mbështetje.

Disa të drejta të afirmuara rishtazi në Kodin e Procedurës Penale krijojnë mundësi për informimin dhe mbështetjen e viktimave. Nisur nga përmbajtja e nenit themelor për të drejtat e viktimave në KPP (neni 58), mund të veçojmë si vijon, këto të drejta:

- Të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;

⁵⁷ Ky klasifikim kryhet mbi bazën e Direktivës “2012/29/eu” e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (25 tetor 2012).

- Të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- Të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
- Të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- Të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;

Nga sa më sipër, konstatojmë se pjesa më e madhe e tyre duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga organi procedues. Ndërsa, e drejta për të kërkuar informacion për gjendjen e procedimit, si dhe për t'u njohur me aktet dhe provat, kërkon nismën e viktimës (përfaqësuesit të saj), te informacionit që i jepet drejtpërdrejt nga organet përkatëse dhe në çdo kohë. Kodi vendos edhe organin përgjegjës që do të kryejë veprimet për të përmbushur të drejtat e viktimës në proces. Ai sanksionon shprehimisht se, “*Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura ...dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre*” (neni 58/2). Kjo do të thotë se, që në fazat e hetimit, Policia gjyqësore dhe Prokuroria e informojnë viktimën, (përfaqësuesin ose trashëgimtarët e saj) në lidhje me këto të drejta. Natyrisht, ende pa filluar shqyrtimi gjyqësor, gjykata duhet të verifikojë e të konfirmojë informimin e viktimës.

3.2.2 Të drejtat e viktimës për të marrë pjesë në procesin penal.

Një nëngrup mjaft i rëndësishëm përbëhet nga të drejtat e viktimës për të marrë pjesë në procesin penal. Konkretisht, në lidhje me procesin penal viktima ka të drejtë:

- Të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- Të zgjedhë mbrojtës dhe kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas sipas legjislacionit në fuqi;
- Të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- Të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- Të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- Të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifave gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

- padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- Të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- Të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar.

Edhe në këtë nëngrup është e rëndësishme të shquajmë të drejtat që zbatohen me kërkesën e vetë viktimës, nga ato që duhet të zbatohen drejtpërdrejt nga institucionet, pa pasur nevojë për ndonjë kërkesë (shih më poshtë).

3.2.3 Të drejtat që lidhen me mbrojtjen e viktimave.

Standardet ndërkombëtare kanë parashikuar të drejta të tjera që lidhen me mbrojtjen e viktimave. Këto të drejta e mbrojnë viktimën nga viktimizimi dhe riviktimizimi, nga kërcënimet e pasiguria. Në bazë të tyre kryhet vlerësimi individual i viktimës, identifikimi i nevojave të saj për mbrojtje ose mbrojtje të veçantë, etj. Në fakt, në ndryshimet e KPP disa nga këto të drejta janë sanksionuar vetëm në dispozita të veçanta, si ato të parashikuara nga neni 58/b.

3.3 Të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në kuptimin e posaçëm.

Në lidhje me viktimat e trafikimit, Kodi ka parashikuar shprehimisht të drejta të posaçme (neni 58/b), të cilat u përkasin atyre specifikisht. Të drejta të posaçme janë parashikuar për këtë kategori, si dhe për viktimat e dhunës seksuale. Viktima e trafikimit të qenieve njerëzore, përveç sa KPP sanksionon për të drejtat e përgjithshme, ka gjithashtu të drejtë:

- Të pyetet pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini;
- Të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;
- Të kërkojë të dëgjohet nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Të drejta të tjera posaçme, të cilat kanë karakter mbrojtës dhe duhet të jenë në vëmendje të profesionistëve janë parashikuar në lidhje me viktimën e mitur. Ndodh që viktimat e trafikimit dhe të shfrytëzimit seksual të jenë të mitura, por më të shpeshta kanë qenë rastet kur ato kanë qenë të mitura në kohën kur ka filluar shfrytëzimi dhe kanë mbushur moshën madhore kur ka filluar procedimi penal.

Përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të KPP, viktimi e mitur ka të drejtë:

- Të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- Të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- Të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

Por, profesionistët e organeve proceduese, në rastet kur viktimi është e mitur zbatojnë njëkohësisht jo vetëm dispozitat e sipërpërmendura, si dhe të drejta të tjera të parashikuara në këtë kod, por edhe të drejta të tjera të parashikuara në legjislacionin e posaçëm. Më i plotë paraqitet kuadri i të drejtave për viktimat fëmijë, pasi plotësohet edhe nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit (Ligj nr. 37/2017). Në këtë rast, Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, përmban të drejta të posaçme për praninë e detyrueshme të psikologut në fazat e procedimit, të ndihmës ligjore dhe psikologjike të detyrueshme për të miturit, etj. (shih: nenet 18-20 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit).

3.4 Të drejta të tjera të parashikuara për viktimat në procesin penal.

Në nenin 58 të KPP është parashikuar edhe një referencë e përgjithshme që sanksionon se viktimi ushtron edhe të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod (neni 58/1/j). Kjo dispozitë u referohet neneve të tjera të KPP ku janë parashikuar të drejtat e posaçme (të sipërpërmendura). Ajo u drejtohet gjithashtu, të drejtave për veprime të ndryshme procedurale që parashikohen në vijim në KPP. Edhe viktimat akuzuese (neni 59), çështja e të cilave ndiqet me kërkesë të drejtpërdrejtë në Gjykatë, janë subjekt i të drejtave procedurale. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nuk janë viktimi akuzuese, porse disa nga veprat penale të parashikuara për rastet kur viktimi i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës, mund të jenë të lidhura edhe me veprën penale të trafikimit.

3.4.1 Të drejtat që parashikohen për trashëgimtarët e viktimave.

Trashëgimtarët e viktimës së veprës penale kanë të drejta të parashikuara shprehimisht nga ky kod. Në ndryshim nga vetë viktimi, trashëgimtari mund kërkojë ose ka të drejta sa vijon:

- të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin

- dhe përfundimin e gjykimit;
- të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

Në KPP nuk kemi një përkufizim për trashëgimtarin e viktimës, por nga mënyra se si është trajtuar ai, na bën të mendojmë se, pozita e trashëgimtarit të viktimës në procesin penal nuk është e barabartë me atë të viktimës. Të drejtat që u njihen trashëgimtarëve janë ato të informimit dhe të të drejtës për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Megjithatë, ka edhe disa të drejta që lidhen drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e procesit penal, si e drejta e trashëgimtarit për të denoncuar dhe për të kërkuar ndjekjen penale të fajtorit, për të paraqitur ankim kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen. Sa më sipër, na shtyn në konkluzionin se trashëgimtari mund t'i pretendojë këto të drejta vetëm në rastin kur viktima ka vdekur, ndërkohë që viktima e mbijetuar është vetë palë në procesin penal. Sidoqoftë, mbetet një çështje e praktikës gjyqësore përpunimi i një përkufizimi të plotë, se cili konkretisht do të jetë trashëgimtari i viktimës në procesin penal, pasi ky Kod nuk e jep një përkufizim të tillë.

3.5 Klasifikimi i të drejtave të viktimave bazuar në mënyrën e ushtrimit të tyre.

Nga ky këndvështrim është e rëndësishme që profesionistët e sistemit të drejtësisë t'i dallojnë të drejtat procedurale të viktimave në dy grupime të drejtash: 1. *Të drejtat e viktimës që ushtrohen mbi bazën e kërkesës së tyre* dhe 2. *Të drejtat e viktimës që ushtrohen drejtpërdrejt nga organi procedues.*

3.5.1 Të drejtat e viktimës që ushtrohen mbi bazën e kërkesës së saj/tij.

Është e rëndësishme që këto të drejta të jenë në vëmendje të avokatëve ose të përfaqësuesve ligjorë të viktimës, pasi ato nuk mund të ushtrohen pa kërkesën e vetë viktimës. Për më tepër, në mjaft raste këto të drejta kanë edhe afate për t'u kërkuar. Vetia kryesore e këtyre të drejtave është që të kërkojnë prej viktimës, me shkrim ose me gojë, përpara organeve përkatëse. Kurse detyrimi i organeve shtetërore mbetet informimi i viktimës për këto të drejta. Në këtë kategori të drejtash mund të përfshijmë sidomos:

- Të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- Të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
- Të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- Të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- Të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- Të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale.

3.5.2 Të drejtat e viktimës që ushtrohen drejtpërdrejt nga organet e drejtësisë.

Në këtë rast, këto të drejta duhet të jenë në vëmendje të veçantë të Prokurorit, Gjykatës, si dhe oficerit të policisë gjyqësore, pasi të drejtat e renditura më poshtë duhet të ushtrohen drejtpërdrejt prej tyre, pavarësisht nëse viktimë ose përfaqësuesi i saj kanë kërkuar ose jo. Në këtë rast, avokati i viktimës ose përfaqësuesi i saj ligjor kanë detyrë të jenë të vëmendshëm për të identifikuar nëse janë përmbushur këto të drejta, si dhe për të kërkuar në vijim respektimin e tyre nga organet përgjegjëse, deri në ankim për shkelje procedurale. Këtu mund të përfshihen veçanërisht, të drejtat si më poshtë:

- Të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- Të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- Të zgjedhë mbrojtës dhe kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas sipas legjislacionit në fuqi;
- Të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- Të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
- Të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- Të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

3.6 Çështje të aksesit në drejtësi të viktimave të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Nevoja për një mentalitet të ri të profesionistëve të drejtësisë.

Në pamundësi për t'i trajtuar me hollësi të gjitha të drejtat do të ndalemi në disa prej tyre, veçanërisht në të drejtat që lidhen me aksesin në drejtësi, me qëllimin për të evidentuar çështjet dhe problemet që hasim për zbatimin e tyre.

3.6.1 E drejta e viktimës për t'u mbrojtur me avokat.

Ligji për ndryshimet në KPP, sanksionon rishtazi të drejtën e viktimës *të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi* (KPP neni 58/1/ç); Çështja që shtrohet në këtë aspekt është se, si do të zbatohet kjo dispozitë. Për këtë, në radhë të parë, theksojmë se ligjvënësi e ka parashikuar mbrojtjen e viktimës si një e drejtë dhe nuk shohim mundësi për ta parë atë si një mbrojtje të detyrueshme, rastet për të cilën, parashikohen vetëm nga neni 49 të Kodit të Procedurës Penale. Prandaj, jemi përpara të drejtës së viktimës për të zgjedhur një avokat, e cila duhet të realizohet nga vetë viktimja ose përfaqësuesi i saj. Organi procedues e informon atë. Ndërsa, kur Kodi sanksionon se, *“kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi”*, atëhere gjykata cakton një avokat në bazë të listës së vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Kjo procedurë duket e ngjashme me atë që ka sanksionuar neni 49/a i Kodit të Procedurës Penale për të pandehurin që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme dhe kërkon një mbrojtës. Ky është komenti që mund të bëjmë nga pikëpamja formalo-ligjore. Por, faktikisht, viktimat e veprave të rënda penale që kanë sjellë vdekjen ose dëmtimin e rëndë të saj, ato të trafikimit të qenieve njerëzore, të marrëdhënieve seksuale me dhunë, të dhunës në familje etj., janë mjaft vulnerabël, jo vetëm për arsye ekonomike, por edhe për shkak të pasojave të ardhura nga vepra penale. Do të kishte qenë më e arsyeshme që legjislacioni të parashikonte një mbrojtje të detyrueshme për këto raste, me avokatë të specializuar për mbrojtjen e viktimave.

Sistemi i sanksionuar aktualisht për ndihmën juridike, parashikon që personat në nevojë t'i drejtohen privatisht Komisionit të Ndihmës Shtetërore për të përfutur ndihmë ligjore falas. Ky sistem nuk ka rezultuar aspak efikas dhe nuk e ndihmon aspak procesin për caktimin e një mbrojtësi falas për viktimat, për shkak të vonësive burokratike ose për shkak se ka mjaft raste të pafuqisë financiare për akorduar avokatë falas. Presim të miratohet dhe të hyjë në fuqi ligji i ri *“Për ndihmën juridike”*, i cili shpresojmë të rithemelojë këtë sistem, duke e bërë efektiv. Për sa më sipër, është i nevojshëm një mentalitet i ri për trajtimin e viktimave me mbrojtës të specializuar. Sidoqoftë, mbetet e

rëndësishme përgatitja e avokatëve të specializuar për mbrojtjen e viktimave të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore.

3.6.2 E drejta e viktimës për t'u përjashtuar nga shpenzimet.

Amendamenti i KPP-së ka parashikuar rishtazi të drejtën e viktimës që në kushte të caktuara me ligj, të përjashtohet nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifave gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale. Edhe kjo është një e drejtë mjaft e rëndësishme për aksesin në drejtësi të viktimave, në qasje edhe me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian dhe duhet trajtuar si e drejtë që zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet, dhe jo si një e drejtë që përfitohet me kërkesën e viktimës.

Duke sjellë në vëmendje praktikën që kemi pasur për të kërkuar përpara gjykatës dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit, theksojmë se zbatimi i kësaj të drejte kërkon një angazhim më të mirë të institucioneve përkatëse. Ne në punën tonë si avokatë, jemi sprapsur disa herë nga kërkimi i dëmit për viktimat e trafikimit, pasi nuk mund të paguanim, sidomos përqindjen e objektit të padisë dikur 3%, të shumës, aktualisht në 1% të shumës, e cila mbetet një shumë e konsiderueshme. Realisht, përjashtimi i viktimës nga taksat, nuk është një e drejtë e panjohur. Pas një interpretimi që i ka bërë ligjit Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda⁵⁸, e cila ka përjashtuar nga të gjitha detyrimet financiare viktimën në kërkesën e saj për shpërblimin e dëmit të ardhur nga vepra penale, kjo praktikë ishte pranuar edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Natyrisht, parashikimi i saj me ligjin e ri garanton zbatimin jo vetëm si standard i një gjykate, por si një normë e detyrueshme për të gjitha gjykatat dhe të gjitha llojet e veprave penale. Problemi që mbetet në këtë rast është që, kjo dispozitë të pranohet dhe të zbatohet në mënyrë të detyrueshme jo vetëm nga gjykatat penale, por edhe nga ato civile. Këto të fundit paraqiten si një kërkesë e domosdoshme, për shkak të veçimit të padisë civile nga procesi penal, një masë që gjykata penale e ndërmer në mënyrë të rëndomtë. Praktikisht, në asnjë rast nga ato që ne kemi ndjekur për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit, padia civile në procesin penal nuk është gjykuar nga vetë Gjykata Penale, por është përfunduar nga ajo civile, për shkak të veçimit që Gjykata penale i bën vazhdimisht gjykimit të dëmshpërblimit. Gjykata Civile, zbaton Kodin e Procedurës Civile dhe aktet ligjore për tarifave gjyqësore. Madje, kemi pasur edhe raste, kur kërkesëpadia është kërkuar të ringrihet mbi bazën e kërkesave të Kodit të Procedurës Civile, duke filluar gjithçka nga e para.

Prandaj, ka nevojë për një mentalitet të ri të gjykatave, për respektimin e të

⁵⁸ Shih: Vendimi i Gjykatës së Apelit për Krimeve të Rënda, nr. 19, dt. 20.03.2008

drejtës për përjashtimin e viktimave nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Kjo është një e drejtë e rëndësishme jo vetëm për aksesin e viktimave në drejtësi, por edhe në bazë të parimit të “*zellit të duhur*” nga ana e shtetit, pavarësisht nga fakti nëse institucionet shtetërore kanë qenë përgjegjëse drejtpërdrejt, apo në mënyrë të tërthortë për ardhjen e veprës penale.

3.6.3 E drejta e viktimës të kërkojë shpërblimin e dëmit në procesin penal.

Ligji i ri për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale sanksionon të drejtën e viktimës të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal. Kjo është një e drejtë që ushtrohet mbi bazën e kërkesës së vetë viktimës, prandaj informimi i saj është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e kësaj të drejte. Me ndryshimin që ka pësuar neni 61 i KPP, është sanksionuar jo vetëm e drejta që viktima të kërkojë në procesin penal shpërblimin e dëmit material sikurse ishte i parashikuar, por edhe të atij jomaterial (dëmin moral). Padyshim, mundësia për të kërkuar dëmin moral në procesin penal është një hap i rëndësishëm, nëse këto dispozita do të gjejnë zbatim dhe do të kenë efektivitet. Sikurse e theksuam, deri më sot procesi penal ka qenë krejt i pafuqishëm të sigurojë gjykimin e padisë civile në procesin penal. Në rastin e gjykimit të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, Gjykata e Krimeve të Rënda i ka veçuar nga procesi penal të gjitha kërkesat për shpërblimin e dëmit. Çështja që shtrohet është se si mund të ndihmojë Kodi i Procedurës Penale që ky mjet të ketë efektivitet dhe të mos mbetet një mjet deklarativ dhe formal. Në radhë të parë, mendojmë se kërkimi i dëmit moral do të ketë më tepër efektivitet në procesin penal, meqenëse procesi i të provuarit në këtë rast, lidhet drejtpërdrejt me procesin e të provuarit të fajësisë së të pandehurit. Në këtë situatë, gjykata do të ketë më të lehtë të vendosë një masë dëmshpërblimi moral për viktimën. Për të akorduar një dëm moral nuk është e nevojshme të veçohet padia civile për kërkimin e dëmit nga procesi penal. Nga ana tjetër, është e nevojshme të ndiqet një praktikë e re për të garantuar efektivitetin e këtyre dispozitave. Meqenëse si shkak kryesor për të vonuar procesin ka qenë mungesa e provave, ne mendojmë se ky ligj jep të gjitha mundësitë që këto prova të administrohen qysh në fazën e hetimit. Oficeri i policisë gjyqësore mund të mbledhë provat përkatëse për faktet që vërtetojnë dëmin. Në nenin 58 që sanksionon të drejtat e viktimave në kuptimin e përgjithshëm, ligjvënësi ka shtuar dispozitën me këtë përmbajtje: “*Viktima e veprës penale ka të drejtë të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues*”. Sidomos dëmi moral mund të çmohet automatikisht nga gjykata mbi provat e administruara në dosje për veprën penale nga Prokurori. Kjo praktikë do

të qaste më mirë të gjitha veprimet e prokurorit, me qëllim që në fashikullin përkatës të përfshihen edhe aktet e kërkesës për pranimin e padisë civile në procesin penal, sikurse parashikon edhe neni 332, pika 1/a e tij.

Suksesi i këtyre dispozitave në mbrojtje të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore do të varet edhe nga zbatimi i ligjeve të tjera ndihmëse, si ligji “Për Ndihmën Juridike” dhe sidomos i ashtuquajturi ligji antimafia (ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009). Ky i fundit lidhet veçanërisht me zbatimin real të vendimeve gjyqësore për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Deri më sot, nuk kemi pasur ndonjë vendim gjykate të ekzekutuar për dëmshpërblimin e kësaj kategorie viktimash. Ne mendojmë se ky ekzekutim mund të lidhet me ndryshimet e reja në Kod, si dhe me risitë në ligjin për nr. 70/2017, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, të ndryshuar. Ndryshimi i neni 37 të këtij ligji dhe parashikimi në ‘të i mundësisë që të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji të përdoren edhe për *dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor* (neni 34 i ligjit), parashtron nevojën që të kemi vendime të ekzekutueshme realisht. Por, kjo kërkon një mentalitet të ri, si dhe akte të brendshme për rregullimin e praktikave të punës nga Agjencia përkatëse e administrimit të pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara.

Në përfundim, mund të themi se, të gjitha amendimet e Kodit të Procedurës Penale sjellin një përmirësim të statusit të viktimës në procesin penal, por zbatimi i tyre kërkon një mentalitet të ri dhe një angazhim të ri nga të gjitha organet dhe profesionistët e drejtësisë.

Sandër Simoni

Kryetar i Gjykatës për Krime të Rënda, Pedagog i Jashtëm në Shkollën e Magjistraturës

4. GJYKIMI I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE.

4.1 Çështje të gjykimit të veprave penale të trafikimit dhe kompetencës lëndore të tyre. Ndryshimet e reja ligjore në legjislacionin procedural.

Trafikimi i qenieve njerëzore është krim i rëndë dhe shkelja më e rëndë e të drejtave themelore të njeriut, që bie ndesh me vlerat e humanizmit njerëzor pasi ka si *corpus delicti* vetë qenien njerëzor: femrën, të miturin, emigrantin etj. Prandaj dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore ka kompleksitetin e vet për shkak të natyrës së këtij fenomeni kriminal, pozicionit të viktimave të trafikimit gjatë gjykimit, dhe standardeve ndërkombëtarë për trajtimin e tyre që duhen përmbushur gjatë gjykimit, si dhe kujdesit që gjyqtarët duhet të tregojnë për të balancuar të drejtat e viktimave e interesin e tyre me garancitë procedurale e ligjore të të akuzuarve. Për rrjedhojë gjykimi i tyre kërkon njohje të mirë të kuadrit ligjor shqiptar dhe atij ndërkombëtar e në të njëjtën kohë njohjen e praktikës gjyqësore të deritanishme të gjykimit të këtyre veprave penale.

Kodi ynë penal parashikon si forma të trafikimit të qenive e njerëzore atë të emigrantëve, femrave për prostitucion dhe si formë më vete atë të trafikimit të të miturve: “*Trafikimit të qenieve njerëzore*“, neni 110/a i KP⁵⁹ dhe “*Trafikimi i të miturve*”, neni 128 i KP. Vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore ishte në kompetencën e hetimit e gjykimit të institucioneve të veçanta të ngritura në vitin 2004⁶⁰ si Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Krimeve të Rënda, pasi trajtoheshin në mënyrë të veçantë si krime të rënda e në të njëjtin nivel me ato të krimit të organizuar.

Neni 75/a i KPrP parashikonte që veprat penale “*Trafikimit të qenieve njerëzore*“, neni 110/a i KP⁶¹ dhe “*Trafikimi i të miturve*”, neni 128 i KP ishin në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Kjo përkonte

⁵⁹ Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave”, neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i KP.

⁶⁰ Ligji nr. 9110 datë 24.07.2003 „Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda „.

⁶¹ Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave”, neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i KP.

më strategjine në nivel shtetëror dhe kombëtar në luftën kundër trafikimit⁶² dhe një praktikë të konsoliduar hetimore dhe gjyqësore në trajtimin e këtyre veprave penale, e në mënyrë të veçantë në trajtimin e viktimave nga kjo veprimtari kriminale.

Me ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale⁶³ *vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore* ku përfshihet dhe *trafikimi i femrave* si dhe ajo e *trafikimit të të miturve* do të gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.⁶⁴ Mendimi ynë ka qënë që Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar duket të ketë të njëjtën kompetencën lëndore si Gjykata e Krimeve të Rënda përse i përket veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, armëve, narkotike si dhe akteve terroriste. Kjo pasi kjo natyrë kriminaliteti në aktet ndërkombëtare në nivelin e OKB e atyre të Këshillit të Europës konsiderohen forma të krimit të organizuar. Konventa e OKB “Për luftën kundër krimit të Organizuar Ndërkombëtar”, jep konceptin e *krimit të rëndë (serious crimes* – në referim të nenit 2 shkronja b) të Protokollit të Palermos në Shqipëri, dhe cilëson si formë të krimit të organizuar trafikimin e qenieve njerëzore, të emigrantëve, femrave për prostitucion dhe fëmijëve⁶⁵. Gjykimi i deritanishëm i këtyrë çështjeve nga Gjykata për Krime të Rënda ka bërë të mundur zbatimin e standardeve mbi trajtimin e viktimave, aplikimin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, dëshmitarëve të mbrojtur, pyetjen në distancë dhe zbatimin e një politikë penale adekuate ndaj autorëve të këtyre veprave penale. *Gjykata e Krimeve të Rënda, sot ka në gjykim çështje të rëndësishme trafikeve të narkotikëve, të armëve e të qenieve njerëzore, të cilat nuk janë në formën e bashkëpunimit të veçantë por që kanë nevojë për aplikimin e instituteve të veçanta procedurale apo dispozitave të veçanta procedurale të përmenduar më sipër në mënyrë që të shqyrtohen me sukses.*

Kujtojmë këtu se hetimi dhe gjykimi i çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore, të narkotikëve apo të armëve janë të lidhura ngushtë me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar dhe vetëm një gjykatë e specializuar dhe e posaçme mund t'i trajtojë ato. Shpërndarja e hetimit të gjykitimit për

⁶² Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014 – 2017, VKM nr. 663 datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 814 datë 26.11.2014.

⁶³ Ligji nr. 35/2017 „Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale në RSH”.

⁶⁴ Sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 35/201, nenet që rregullojnë kompetencën bëhen të zbatueshme me krijimin e Gjykatës së Posaçme Antikorrupsion dhe Krimin të Organizuar çështjet penale prandaj deri atëherë çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore e të miturve do të gjykohen nga Gjykata për Krime të Rënda.

⁶⁵ Protokollit 1 dhe 2 shtesë i Konventës së OKB “Për luftën kundër krimit të organizuar “.

këtë natyrë çështjesh në prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore do të dëmtonte hetimin e fakteve kriminale e të mekanizmit të ngjarjeve që shpesh shtrihet në gjithë territorin e RSH dhe jashtë vendit. Mirëpo legjislatori në përcaktimin e nocionit “krim i organizuar“, u kufizua vetëm tek format e bashkëpunimit të veçantë të parashikuara në kudër të nenit 28 të KP.

Prandaj dhe është e rëndësishme përcjellja e kësaj eksperience të mirë në trajtimin e këtyre çështjeve edhe për prokuroritë e gjykatat e tjera të juridiksionit të përgjithshëm, gjyqtarët e të cilave do të kënë tashmë para tyre për gjykim këto çështje delikate. Këtë synon dhe ky manual.

4.2 Ndryshimet e reja në legjislacionin tonë penal dhe procedural.

Legjislacioni penal dhe ai procedural kanë ndryshuar në drejtim të adaptimit të “viktimologjisë” si koncept. Me ndryshimet në legjislacionin penal në vitin 2013⁶⁶, në nenin 52/a të KP, u fut për herë të parë termi “viktima“, duke u parashikuar përjashtimi ose ulja e dënimit për viktimat e trafikimit sipas së cilës, personat e dëmtuar nga vepra penale që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojnë përjashtimin nga dënimi për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qënë i detyruar t’i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.

Ndryshimet e fundit në Kodin Penal⁶⁷ kanë sjellë risi të rëndësishme në raport me mbrojtjen e viktimës nga vepra penale si në rastet e vrasjeve ndaj personit, krimeve seksuale, ashtu dhe ndaj veprave penale të trafikimit. Kështu përsa i përket rrethit të personave të cilët gëzojnë mbrojtje, Kodi Penal ka përfshirë dhe bashkëjetuesin apo ish-bashkëjetuesin, ndërsa tek krimet seksuale sigurojnë mbrojtje më të madhe për dinjitetin e personit ndaj veprimeve kërcënuese, degraduese apo ofenduese që mund të përbëjnë ngacmim seksual. Ndërsa neni 110 mbi trafikimin e personave përfshin tashmë dhe trafikimin brenda territorit të vendit, një koncept ky i njohur nga Konventa e Këshillit të Europës kundër Trafikimit.

Legjislacioni procedural shqiptar ka ndryshuar⁶⁸ dhe tashmë viktima nga vepra penale e trafikimit është subjekt procedural me të drejta procedurale të caktuara ndaj së cilës organet proceduese duhet të përmbushin një sërë detyrimesh. Kodi ka sanksionuar detyrimin pozitiv të organeve publike që të

⁶⁶ Ligji nr. 144/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH”.

⁶⁷ Ligji nr.144 /2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895 , datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH”, të ndryshuar .

⁶⁸ U referohemi ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale i RSH”.

garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.⁶⁹ Është parashikuar detyrimi për pjesëmarrjen si palë në proces të viktimës së veprës penale, duke garantuar aksesin e saj në procesin penal në referim të përcaktimit të Vendimit Kuadër të BE mbi statusin e viktimave në gjykimin penal të datës 15/03/2001.

Tashmë është zëvendësuar figura e “të dëmtuarit nga vepra penale” me termin “viktimë” dhe atë të “të dëmtuarit akuzues” me termin “viktima akuzuese”, duke dhënë edhe përkufizimet e rregullimet përkatëse për këto subjekte në përputhje me Vendimin Kuadër të 15 marsit 2001 mbi qëndrimin e viktimave në procedimet penale, si dhe Direktivën 2012/29 /BE që e ka zëvendësuar këtë vendim.

- Neni 58 është riformuluar tërësisht⁷⁰ dhe pas tij janë shtuar nenet 58/a dhe 58/b, në të cilin janë parashikuar si figura të posaçme *viktima e mitur* dhe *viktima e abuzuar seksualisht* apo *subjekt i trafikimit*.⁷¹ Në këto dy raste është parashikuar që viktima të ketë edhe disa të drejta të posaçme që lidhen me vetë cilësitë e saj të veçanta;
- Është shtuar neni 59/a, i cili parashikon rastin e viktimave të shumta nga vepra penale, me qëllim shmangien e zvarritjes së procesit për këtë shkak, duke garantuar përfaqësimin e tyre nga i njëjti mbrojtës në rastet kur nuk ka pengesë;
- Në nenin 60 është parashikuar në mënyrë të detajuar përmbajtja e kërkesës së viktimës akuzuese, me qëllim mundësimin e zhvillimit të një procesi gjyqësor normal;
- Gjithashtu, është parashikuar se padinë civile në procesin penal mund ta ngrejë vetëm viktima ose trashëgimtarët e saj.

4.3 Gjykimi i veprave penale të trafikimit dhe të drejtat e viktimave gjatë procesit gjyqësor penal.

Në gjykimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore e në veçanti rastet kur kemi trafikim nëpërmjet shfrytëzimit seksual të femrave dhe të miturve, faza më e rëndësishme dhe delikate është ajo e gjykimin për shkak se në këtë fazë viktimat ballafaqohen me persona të tjerë, të akuzuarin e mbrojtësin e tij, sallën e gjykimin e publikun.

⁶⁹ Neni 9/a i KPrP “Të drejtat e viktimës nga vepra penale”.

⁷⁰ Neni 58 i KPrP i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

⁷¹ Veç të drejtave të parashikuara.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Kontakti i gjykatës me viktimën e trafikimit mund të jetë dhe **gjatë fazës së hetimeve paraprake**, kur kërkohet sigurimi i provës së thënieve të viktimave të abuzara nga trafikantët sipas nenit 316 të KPrP. Shkonja b) e këtij neni parashikon rastin tipik të sigurimit të provës së thënieve të dëshmitares/it/viktimë nga veprimet e trafikimit të qenieve njerëzore :

...kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje për të dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt.

Kërkesa për sigurimin e provës mund të paraqitet edhe **në fillim të seancës paraprake** sipas nenit 317 të KPrP⁷². Ndërkohë që me ndryshimet e fundit në KPrP, në nenin 318⁷³ është parashikuar që viktima në këtë rast viktima nga trafikimi, mund t'i drejtohet prokurorit që ai të kërkojë sigurimin e provës. Viktimat e trafikimit nga veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore janë persona vulnerabël e në paaftësi për të njohur e kërkuar të drejtat e tyre si subjekte procedurale prandaj në këtë rast është e rëndësishme asistenca e nevojshme juridike e psikologjike në mënyrë që tu sigurohet mbrotja falas. Viktima ose përfaqesuesi i saj marrin pjesë në seancën e sigurimit të provës.

Ky pozicionim i ri viktimës dhe kapaciteti i të drejtave procedurale efektive të tyre në legjislacionin tonë procedural, vjen si detyrim i zbatimit të Konventave të OKB⁷⁴ dhe Këshillit të Europës⁷⁵ në të cilat ne kemi aderuar si vend e që janë pjesë e legjislacionit të brendshëm, cituar më sipër në këtë punim, por edhe në njohje e duke i paraprirë adaptimit të legjislacionit evropian nën frymën e akteve të tjera në kuadër të BE si:

- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të e 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimale mbi të Drejtat,

⁷² Neni 317 i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”.

⁷³ Neni 318 i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”.

⁷⁴ Konventa e kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar dhe dy protokollet shtesë të tij, të ratifikuara me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002.

⁷⁵ Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore“, e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006.

Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”.

Si gjyqtari i hetimeve paraprake ashtu dhe ai i seancës paraprake në rastet kur kanë një kërkesë për sigurimin e provës të thënieve të një viktime trafikimi, duhet të bëjnë kujdes në vlerësimin e kriterëve mbi të cilat është bazuar kërkesa pasi kjo kategori dëshmitarësh janë kategoria më e dobët e personave ndaj të cilëve qoftë presioni, dhuna psikologjike por dhe vetë ambienti apo fakti që janë të përfshirë në një procedim si persona që kanë dhënë deklaratime, ndikon në qëndrueshmërinë e thënieve të tyre e në mënyrë të veçantë në trajtimin e viktimave të trafikimit, shoqërimin e tyre në gjykatë, asistencën psikologjike dhe atë ligjore.

E rëndësishmë për këtë fazë të procedimit është kujdesi në trajtimin e viktimës në mënyrë që të shmanget jo vetëm derogimi i deklaratimit, të dhënave përfituese për procedimin apo ndryshimi i tyre para se ato të sigurohen por dhe riviktimizimi si rezultat i presionit të ambienteve të seancave të sigurimit të provës, kontakti me të pandehurin, ballafaqimi me të, avokatët apo familjarët e tij.

Avantazh në këtë fazë është rasti kur viktimat e trafikimit janë në proces mbrojtje efektive ose mbrojtje të posaçme dhe gjenden përkohësisht në strehëzat antitrafik ose asistohen nga organizata dhe agjencitë e organizatat e tjera që asistojnë psikologjikisht apo materialisht këtë kategori. Si të tilla në Shqipëri janë disa Qendra që sigurojnë mbështetje dhe asistencë për viktimat e trafikimit. Këto qendra dhe agjenci janë në përbërje të Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik dhe ndihmohen e asistohen nga Kordinatori Kombëtar Antitrafik, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Në çdo rast gjyqtari, si ai i hetimeve paraprake, i seancës paraprake apo i gjykimit të çështjes, duhet të ketë parasysh tërësinë e të drejtave të viktimave, e të miturve dhe atyre të trafikimit në veçanti të parashikuara në mënyrë eksplicite të qartë nga KPrP. si më poshtë:

- Të ketë ndihmë mjeksore, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat,⁷⁶
- Të ketë në dispozicion një avokat mbrojtës, duke u përjashtuar në të njëjtën kohë nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës

⁷⁶ Neni 58 i KPrP “Të drejtata e viktimës së veprës penale“.

së veprës penale;

- Të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- Të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal; të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- Të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

Në çdo rast gjykata duhet t'ia bëjë të ditur këto të drejta viktimës, megjithëse ky detyrim është dhe për prokurorinë gjatë fazës së hetimeve. Momenti i bërjes së ditur të këtyre të drejtave duhet të dokumentohet në procesverbal qoftë të sigurimit të provës, të seancës paraprake apo gjykimit të çështjes. Gjyqtari i seancës paraprake verifikon nëse prokuroria gjatë fazës së hetimeve ka përmbushur detyrimet nga subjekti procedural të viktimës. Gjatë seancës paraprake viktimë ka të drejtë të paraqesë pretendime në lidhje me veprimet hetimore të kryera ndaj autorit apo në njohje të saj/tij menjëherë pas të pandehurit.⁷⁷

Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të saj, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara⁷⁸. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

Në zbatim të këtyre dispozitave do të lindë diskutimi se cili do të jetë trashëgimtari ligjor dhe nëse referenca duhet të bëhet në dispozitat e Kodit Civil bazuar në rradhën e preferimit. Gjithashtu, mund të lindë diskutimi nëse viktimë duhet të varet në çdo rast nga trashëgimia. Kjo pasi mund të ketë persona në një lidhje shumë të afërt me viktimën si dhe trashëgimtarë ligjorë në rradhë preferimi të lartë, të cilët mund të kenë shkëputur lidhjet me viktimën. Termi “trashëgimtarë” lehtëson proceduralisht fazën e hetimit e gjykimit, por në fakt si i tillë mund të jetë çdo anëtar i familjes.

⁷⁷ Paragrafi 4 i nenit 332/c sipas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.

⁷⁸ Të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të nenit 58 të KPrP.

Në mënyrë të veçantë Kodi ka shprehur e përcaktuar të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore⁷⁹ që veç të drejtave të parashikuara në nenet 58 dhe 58/a, të këtij Kodi, viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë gjithashtu të drejtë:

- Të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;
- Të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.⁸⁰

Për të miturin viktimat të veprës penale të trafikimit apo shfrytëzimit seksual, Kodi ka parashikuar në mënyrë të veçantë të drejtat dhe garancitë që njohu Konventa e Lanzarote⁸¹, sipas së cilës fëmija viktimë e trafikimit ka të drejtë:

- Të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- Të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- Të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.⁸²

Gjykata duhet ta trajtojë **viktimën e mitur** të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm. Nëse ekziston mundësia që viktimat është e mitur dhe moshë e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

Më tej Kodi ka parashikuar dhe mundësinë e *përdorimit si provë të pyetjes*

⁷⁹ Neni 58/b i Kodit i shtuar me ligjin nr. 35/2017.

⁸⁰ Këto të drejta janë reflektim i të drejtave të garantuara për viktimat nga Konventa e Palermos, Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006. Në mënyrë të veçantë nga Rekomandimi nr. (85) 11-Këshilli i Europës, Vendimi Kudarë i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal e datës 15.03.2001, Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA, Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimet dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

⁸¹ Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual” e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10 071 datë 9.2.2009.

⁸² Shkonjat a, b, c të paragrafit të parë të nenit 58/a të KP.

së të miturit gjatë fazës së hetimeve . Viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohët me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedise të përshtatura për të. Një gjë të tillë e parashikon dhe Kodi i Drejtësisë për të Miturit⁸³, i cili në nenin 39, 41 të tij ka parashikuar rregulla të veçanta për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, dhe të miturin viktimë e shfrytëzimit seksual dhe dhunës seksuale.

Në lidhje me **njoftimin e viktimës** për seancën gjyqësore ashtu sikurse dhe për njoftimin e të pandehurit, tashmë Kodi ka parashikuar mënyra alternative të njoftimit të saj. Sipas ndryshimeve të fundit⁸⁴ njoftimi i viktimës bëhet njëllor sikurse dhe njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë, referim ky në kryerjen e njoftimit sipas nenit 140 të KPrP⁸⁵ dhe kur kjo nuk është e mundur pasi nuk dihen vendet ku ndodhet viktima, njoftimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit të aktit në kryesekretari. Kjo është e kuptueshme pasi në rastet e viktimave të trafikimit nuk mund të bëhet njoftimi publik nëpërmjet shaplljes siç bëhet për të pandehurit në gjendje të lirë sipas pag. 5 të nenit 140 të KPrP, sepse një mënyrë e tillë njoftimi ekspozon atë në publik. Gjithashtu në rastin e viktimave të trafikimit për të njejtën arsye nuk mund të zbatohet neni 138 i KPrP i cili parashikon njoftimin e viktimave nëpërmjet shpalljes publike pasi kjo mënyrë njoftimi i referohet rastit kur kemi viktima një numër të madh personash nga një dëm në shëndet apo material e jo rasti i viktimës nga trafikimi.

Procedura e gjykimit të veprave penale të trafikimit duhet të mbrojtë viktimën e në veçanti viktimën e mitur nga riviktimizimi dhe ekspozimi i jetës private apo detajeve që çënojnë personalitetin e integritetin e saj/ tij. ⁸⁶ Gjykata mund të vendosë që gjykimi të bëhet me dyer të mbyllura kur publiciteti dëmton moralin shoqëror, kur gjykohet e nevojshme për pyetjen e

⁸³ Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit“, i cili hyn në fuqi me datën 1 janar 2018.

⁸⁴ Neni 137 i KPrP i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

⁸⁵ Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë.

⁸⁶ Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore“, e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006 Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të e 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit” dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

të miturit, ose viktimë vetë kërkon të zhvillohet gjykimi me dyer të mbyllura.⁸⁷ Ndërsa shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur të miturit janë autorë të një veprë të tillë ose kur gjykohen të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjykimit.⁸⁸

Në lidhje me **zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura**, viktimë ose përfaqësuesi i të miturit viktimë mund të kërkojë që procesi të zhvillohet me dyer të mbyllura, qoftë edhe vetëm për një pjesë të procesit. Procedohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur personi i dëmtuar është i mitur. Kjo dispozitë ka një rëndësi të madhe sistematike dhe praktike. Përpara së gjithash futja e normave të reja që nuk kanë patjetër natyrë seksuale, pasi trafikimi mund të ketë si qëllim punën e detyrueshme ose servitutit shtëpiak, nënkupton që *la ratio* e normës nuk është mbrojtja më e madhe e nevojshme e personit të dëmtuar, sepse seksualiteti i tij është implikuar në kryerjen e veprës. Në fakt *la ratio* është për të kërkuar mbrojtjen e nevojshme të jetës personale të viktimës, kur janë dëmtuar nga veprat të mirat personale, që përfshihen në një gamë më të gjerë, duke përfshirë lirinë personale, lirinë e vetëvendosjes si në sferën seksuale ashtu edhe më në përgjithësi, pra kur personi ka qenë objekt i një dëmtimi të tillë sa e ka çënuar vetëvlerësimin e tij dhe kuptimin e vetë vlerës së personit të tij. Në këtë situatë, publiciteti vetë mund të jetë një faktor rëndimi i pasojave të dhunimit.

Nga këndvështrimi praktik, personi i dëmtuar duhet të informohet gjithmonë në momentin e kontaktit me autoritetin gjyqësor, mbi të drejtën e tij për të kërkuar që debati ose një pjesë e tij-*tipikisht dëshmia e tij*- të zhvillohet me dyer të mbyllura. Gjyqtari ose kryetari duhet më pas të vlerësojnë në një mënyrë jo shumë shtrënguese ekzistencën e rrethanave për marrjen e një vendimi të tillë. Kjo sipas *Rekomandimit të Këshillit të Europës nr. 85 (2011)*⁸⁹. *Në çdo rast, kjo e drejtë vihet në balancë me të drejtën e të akuzuarit për garantimin e barazisë së armëve gjatë procesit.*

⁸⁷ Neni 340 i KPrP, paragrafi 1 shkronjat a, c, d.

⁸⁸ Rregullat Minimale Standard të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të miturit. (*Rregullat e Pekinit 1985*) Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të Rinjtë (*Udhëzimet e Riadit*).

⁸⁹ Politikat e informimit dhe të marrëdhënies me publikun në kuadrin e instruksionit dhe të gjykimit të veprave penale duhet të kenë parasysh nevojën për të mbrojtur viktimën nga çdo publicitet që mund të paragjykojë jetën e tij private ose dinjitetin e tij. Nëse lloji i veprës penale, statusi i veçantë, situata ose siguria personale e palës së dëmtuar kërkojnë një mbrojtje të veçantë, procesi penal para vendimit duhet të zhvillohet me dyer të mbyllura dhe përhapja e të dhënave personale të viktimës duhet të jetë objekt i shtrëngimeve të përshtatshme.

Kërkesat për zhvillimin me dyer të mbyllura në Gjykatën e Krimeve të Rënda gjithmonë kanë patur rezistencën e të pandehurve të akuzuar e mbrojtësve të tyre të cilët kërkonin ballafaqimin me viktimën akuzuese në sallën e gjykimit. Në disa raste të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre janë larguar nga salla e gjykimit në shenjë proteste të pranimit nga ana e gjykatës së kërkesës për zhvillimin e senacës me dyer të mbyllura.

Një disavantazh në gjykimin e çështjeve të trafikimit është mungesa e njohurive apo pranimi i standardeve ndërkombëtare të avokatëve mbrojtës përsa i përket trajtimit të viktimave të trafikimit të parashikuara nga normat ndërkombëtare të OKB e BE e të cilat ishin pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, por akoma nuk ishin reflektuar në legjislacionin procedural. Prandaj parashikimi tashmë i këtyre të drejtave ndër të cilat dhe ajo për të kërkuar vetë viktimën apo përfaqësuesi i saj/tij/të miturit zhvillimin me dyer të mbyllura apo përdorimin si provë të pyetjes audio vizive gjatë hetimeve, ndihmon gjyqtarët në praktikën e zbatimit të këtyre standardeve.

4.4 Prania e viktimës së trafikimit në seancë gjyqësore dhe pyetja e saj me cilësinë e dëshmitares në seancë gjyqësore.

Gjatë seancës gjyqësore të shqyrtimit të çështjes, viktimën e trafikimit mund të marrë pjesë në pozicionin e viktimës⁹⁰ duke asistuar në proces gjyqësor ose në pozicionin e dëshmitares kur është e nevojshme pyetja e saj me këtë cilësi. Pyetja e viktimës së trafikimit si dëshmitare e sidomos rasti kur kjo/ky është i mitur është pjesa me delikate e procesit. Kur thëniet e dëshmitares/viktimës trafikimi janë siguruar gjatë hetimeve paraprake, apo seancës paraprake situata është më e thjeshtë pasi në seancë gjyqësore lexohen procesverbali i sigurimit të provës. Prania e viktimës së trafikimit si dëshmitar në seancë kërkon plotësimin e disa komponentëve që lidhen me sigurinë, shoqërimin, pozicionimin e saj në ambientet e gjykatës apo sallën e gjykimit.

Pyetja e viktimës së trafikimit mund të bëhet nëpërmjet **mjeteve audio dhe audiovizive** sipas nenit 361 paragrafi 8 i KPrP.⁹¹ Kjo realizohet nëpërmjet lidhjeve me vidiokonferencë ose duke e pyetur dëshmitaren, viktimën, nga një ambient i rezervuar për të ngjitur me sallën e gjykimit, ambient në të cilin ajo nuk ka pamje të drejtpërdrejtë me të pandehurin, avokatin dhe publikun. Kjo mënyrë pyetje bëhet për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave

⁹⁰ Sipas nenit 58 paragrafi 1 shkronja h) viktimën ka të drejtë të thirret nga gjykata në seancën e parë gjyqësore.

⁹¹ Viktimat e veprave penale seksuale, veprave të trafikimit ose veprave të kryera brenda familjes kur e kërkojnë, mund të pyeten si dëshmitare nëpërmjet mjeteve audio dhe audiovizive.

të trafikimit nga kërcënimet serioze të të pandehurve dhe personave të tjerë, nëpërmjet te cilave krijoheshin vështirësi serioze për vërtetimin e fajësisë dhe dënimin e tyre. Sallat e gjykimit në Gjykatën e Krimeve të Rënda janë konceptuar për të realizuar një pyetje të tillë nëpërmjet videokonferencës duke e vendosur dëshmitaren në një ambient në gjykatë ose nga një ambient tjetër jashtë gjykatës ose nëpërmjet lidhjes audio me ambientin e veçantë për to ngjitur me sallën e gjykimit. Kjo mënyrë pyetjeje nëpërmjet lidhjes audio apo audiovizive është praktikuar me sukses në proceset gjyqësore në gjykim në gjykatën tonë.⁹² Në një rast të tillë kryesuesi i seancës bën verifikimin e prezencës së dëshmitares/viktimë dhe një sekretare mban paralelisht një procesverbal në ambientin ku ndodhet dëshmitari. Procesverbali i bashkangjitet proceverbali kryesor të seancës gjyqësor ose rregjistrimit audio.

Sipas pikës 7 të nenit 361 të KPrP, pyetja e dëshmitares/viktimë në distancë mund të bëhet brenda territorit të vendit tonë ose jashtë vendit nëpërmjet videokonferencës. Ligji parashikon që gjatë kësaj pyetjeje në distancë duhet të respektohen rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit tonë të Proçedurës Penale. Dëshmitarja/viktimë trafikimi pyetet nëpërmjet lidhjes audio-vizive dhe personi i autorizuar nga Gjykata qëndron në vendin ku ndodhet ajo dhe bën identifikimin e tij, si dhe kujdesit për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në procesverbal.

Në rastet kur viktima/e trafikuar **zgjedh të jetë prezent gjatë gjykimit** dhe të pyetet në prani të të pandehurit, gjykata duhet të bëjë kujdes që:

- Viktima e trafikimit/dëshmitarja, të shoqërohet nga punonjës policie dhe punonjës socialë ose psikologë mundësisht të së njëjtës gjini⁹³. Në rastet kur viktima ndodhet e akomoduar në qendrat pritëse për viktimat, mundësia e shoqërimit të tyre në mënyrë të asistuar është më e lehtë pasi gjykata urdhëron shoqërimin e saj nga punonjësit e qendrës pritëse.
- Ajo shoqërohet në ambientet e gjykatës nga një hyrje që nuk është e aksesueshme për publikun dhe shoqërohet në një ambient të përcaktuar në mënyrë të posaçme për dëshmitarët (dhoma e dëshmitarëve) ambient në

⁹² Shih vendimin nr. 77 datë 19.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të rënda në ngarkim të pandehurit L.M i akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” neni 128/b/3 i KP ku përshkruhet mënyra e pyetjes me vidiokonferencë nga një ambient i brenshëm i Gjykatës i të miturës/ viktimë trafikimi A. F.

⁹³ Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit” dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

të cilën është e shoqëruar nga punonjësja sociale ose psikologjia⁹⁴, ku dhe qëndron derisa nëpunësi gjyqësor e thërret për t'u paraqitur për pyetje.

- Viktima dëshmitare pozicionohet në një ambient në sallë që të ketë distancë të përshtatshme nga i akuzuari/ i pandehuri në mënyrë që ajo të mos intimidohet e të ndjejë presion psikologjik nga ballafaqimi me të pandehurin⁹⁵.
- Gjykata bën kujdes që gjatë pyetjes nga palët, prokurori, avokatët apo i pandehuri të mos përdoren pyetje, gjeste, sjellje, intonacione që të shkaktojnë presion psikologjik, intimidim, ekspozim të intimitetit apo fyerje e denigrim të viktimës së trafikimit e cila është paraqitur si dëshmitare.

Sipas nenit 361 b/ të KPrP,⁹⁶ kur viktima e trafikimit është dëshmitare e mbrojtur dhe ka përfituar nga programi i mbrojtjes së dëshmitarëve ajo mund të pyetet sipas teknikave të veçanta të marrjes në pyetje ndër të cilat përveç pyetjes në distancë është dhe ajo e fshehjes së identitetit. Në ligjin *"Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"*⁹⁷ janë të përcaktuara rastet kur merret statusi i dëshmitares së mbrojtur⁹⁸ dhe detyrimi i organeve të posaçme administrative për marrjen e masave të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, në vendin ku qëndron personi i mbrojtur, si dhe gjatë lëvizjes së tij, përfshirë edhe ato për përmbushjen e detyrimeve ndaj organeve të drejtësisë. Në lidhje me ndryshimi i identitetit të dëshmitarit të personit që do të pyetet nga gjykata sipas nenit 361/b të KPrP, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose këqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm të tij me qëllim që të përmbushë këtë detyrim. Masat mbrojtëse që mund të urdhërojnë gjykata janë ato që kanë të bëjnë me fshehjen e të gjithë shënimeve

⁹⁴ Shkronja b) e nenit 58 të KPrP.

⁹⁵ Sallat e gjykimit në Gjykatën e Krimeve të rënda sigurojnë këtë komponent pasi kanë një largësi të mjaftueshme me vendin ku pozicionohet viktima.

⁹⁶ Teknikat e veçanta të marrjes në pyetje.

⁹⁷ Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", i ndryshuar me ligjin nr. 10 173 datë 22.10.2009 dhe ligjin nr. ligjin nr. 32/2017 datë 30.03.2017.

⁹⁸ *"Dëshmitari i drejtësisë"* është personi, ndaj të cilit zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes, i cili në cilësinë e dëshmitarit ose personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte dhe rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal, për vepra penale të parashikuara në pikën 7 të këtij neni (përfshihen edhe veprat penale lidhur me trafikimin). Viktimat e trafikimit mund të paraqiten shpesh në këtë pozitë procedurale.

që do të zbulonin identitetin e palës së dëmtuar apo të dëshmitarit, masat për të fshehur tiparet apo përshkrimin fizik të dëshmitarit, seancat me dyer të mbyllura për publikun;

Deri tani në Gjykatën e Krimeve të Rënda nuk kemi patur raste të dhënies së këtij statusi viktimave të trafikimit, por gjithsesi kur ato kanë qënë dëshmitarë gjatë sigurimit të provës apo dëshmisë janë shoqëruar me punonjës policie për në Gjykatë të asistuar nga aktivistë të shoqërisë civile apo të organizatave të ndryshme që ushtrojnë aktivitete në këtë fushë.

4.5 Pyetja e të miturit viktimë e trafikimit.

Përveç rregullave të sipërcituara pyetja e të miturit/ës viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, legjislacioni procedural penal dhe ai i drejtësisë për të miturit kanë parashikuar tashmë rregulla të reja për të ofruar garancitë maksimale për sigurimin e efektivitetit të marrjes së dëshmisë por ajo që është më kryesore trajtimin e përshatshëm të të miturit. Kodi i Drejtësisë për të Miturit jep përkufimimin e “*të miturit*”, “*të miturit viktimë*”, “*riviktimizimit*” si dhe “*interesi më të lartë të të miturit*”⁹⁹

Tashmë neni 361 i KPrP parashikon rregulla të veçanta për pyetje e të miturit.¹⁰⁰ Kështu pyetja e të *miturit/viktimë* trafikimi nën 14 vjeç bëhet pa praninë e gjyqtarit apo të palëve në ambientin ku ai ndodhet dhe kryhet nëpërmjet lidhjeve audiovizive ose audio. Pyetja bëhet nëpërmjet psikologut, edukatorit etj.

Ndërsa pyetja e të miturit viktimë mbi 14 vjeç bëhet nga gjyqtari/kryesues i trupi gjykues që në rastin tonë të gjykimit në shkallë të parë korrespondon me gjyqtarin e çështjes, duke bërë kujdes për të shmatur pasojat e dëmshme në shëndetin e tij në mënyrë që të mos impresionohet apo tensionohet emocionalisht gjatë pyetjes.

Kur i mituri është dëgjuar gjatë hetimit dhe deklaratimet e tij janë regjistruar sipas paragrafit 4 të nenit 58/a të KPrP, ato përdoren si provë në gjykim nëse i pandehuri dhe mbrojtësi japin pëlqimin. Një gjë të tillë e parashikon dhe Kodi i Drejtësisë për të Miturit¹⁰¹, i cili në nenin 39, 41 të tij ka parashikuar rregulla të veçanta për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, dhe të miturin viktimë e shfrytëzimit seksual dhe dhunës seksuale.

⁹⁹ Neni 3 “Përkufizime”. Kodi i drejtësisë për të Miturit i miratuar me ligjin nr. 37/2017.

¹⁰⁰ Neni 361 i KPrP “Pyetja e të miturit 2, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

¹⁰¹ Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”, i cili hyn në fuqi me datën 1 janar 2018.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Kjo e fundit përbën shmegie nga parimi i marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata dhe në dukje përbën një element të sistemit inkuizitor të procesit gjyqësor por duhet të kemi parasysh që e drejta e viktimës së mitur në këtë rast konkurren këtë parim në kuadër të parimit të përgjithshëm të procesit të drejtë gjyqësor që ka si komponent thelbësor po respektimin e garancive për viktimat /të miturit.

Rast praktik 1: Pyetja me vidiokonferencë e një të miture/ viktimë. Vendimi nr.77 datë 19.07.2017. i pandehuri L.M akuzohet për veprën penale të “ Trafikimit të personave të mitur “ nenin 128/b/3 i K.Penal, në dëm të viktimës së mitur A.F, vepër penale e kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Gjatë pyetjes së viktimës së mitur, Gjykata zbatoi dispozitat e parashikuara nga neni 361i K.Pr.Penale dhe nenit 8 të ligjit 9110 datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda“, duke e pyetur të miturën nëpërmjet lidhjes audio-vizive, videokonferencës e vendosur në dhomën e dëshmitarëve në Gjykatën e Krimeve të Rënda, duke arsyetuar se viktima e mitur A.F është një person i mitur, vulnerabël, për shkak të moshës së saj të mitur por dhe gjëndjes familjare, ekonomike në të cilën ndodhet. Në fund Gjykata ka arritur në konkluzionin se e mitura është trafikuar duke u shfrytëzuar fillimisht nga i dashuri i saj dhe më pas nga i pandehuri në një qytet në juglindje të Shqipërisë.

Rast Praktik 2: Vendimi nr. 47 datë 28.07.2009 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka dhënë Vendimin nr. 29 datë 11.06.2007 sipas të cilit i pandehuri A. K. është gjetur fajtor për veprat penale të “*Trafikimit të femrave për prostitucion*”, në dëm të shtetas H. Xh.; “*Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese*”, kryer në dëm të shtetas L. K., dhe “*Fallsifikim të dokumenteve*”, “*Fallsifikim të pasaportave*”, të parashikuara nga nenet 114/b/1, 114/a, pika 3,4,5,6 -25, 189/1, 186 dhe 278/a/2 i K.Penal dhe përfundimisht, në bashkim të dënimeve është dënuar me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Ndaj këtij vendimi është bërë rekurs nga palët dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka dhënë Vendimin nr. 555 datë 03.12.2008, sipas së cilit Vendimi nr 29 datë 11.06.2007 të Gjykatës së shkallës së Parë dhe Vendimi nr 56 date 11.12.2007 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, janë marrë në shkelje të ligjit procedural penal dhe si të tillë janë prishur duke e kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se “*vendimet gjyqësore janë marrë në shkelje të ligjit procedural penal, posaçërisht dispozitave të nenit 158/ç/2 e 151/4 të*

K.Pr.Penale”. Pasi citohet neni 158/ç/2 i *K.Pr.Penale*, në faqen 8 të Vendimit nr 555 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë arsyetohet se:

“Duke analizuar përmbajtjen e kësaj dispozite, vërehet se ligjvënësi, për shkak të ruajtjes së parimeve të një marrëdhënie shoqërore të rëndësishme, sikundër është ajo mes bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, e ka përjashtuar këtë rreth subjektësh nga detyrimi për të dëshmuar gjatë gjykimit të procedimit penal në ngarkim të të afërmeve të tyre, në lidhje me ngjarje e fakte mbi të cilat ato kanë dijeni. Posaçërisht, ligjvënësi i ka njohur një status të veçantë bashkëshortit, ish bashkëshortit, bashkëjetuesit apo personit të lidhur me birësim me të pandehurin në një procedim penal, duke e bërë të detyrueshme për organin e procedurës që në çdo rast, edhe kur kallëzimi i veprës të jetë bërë nga këto subjekte, në momentin e administrimit të dëshmisë atyre duhet t’i bëhet e njohur e drejta për të mos dëshmuar. Në këtë mënyrë, vetë ligjvënësi e ka veçuar këtë rreth subjektësh nga personat e tjerë që parashikon neni 16, të cilët pavarësisht lidhjes me të pandehurin, përsakohë janë në cilësinë e kallëzuesit nuk mund të përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar....

*Në rastin konkret, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se ka qenë detyrim i gjykatës që zhvilloi seancën gjyqësore dhe mori dëshminë e shtetases H. Xh., që konform nenit 158/ç të *K.Pr.Penale*, në momentin kur mori dijeni për lidhjen mes të pandehurit dhe të dëmtuarës, t’i bënte të njohur kësaj të fundit të drejtën që ajo kishte për të mos dëshmuar..... Për shkaqet e mësipërme, dëshmia e të dëmtuarës H. Xh. përbën një provë të administruar në shkelle të ligjit (neni 151/4 i *K.Pr.Penale*), e për rrjedhojë vendimet gjyqësore të cilat u bazuan në të duhet të prishen.....Në marrjen e provave gjatë rigjykimit të çështjes është detyrim i gjykatës respektimi me rigorozitet i dispozitave të procedurës penale me qëllim përmbushjen e parimit të zhvillimit të një procesi të drejtë ligjor. Duke qenë se në vetvete prova, dëshmia e të dëmtuarës H. Xh., nga pikëpamja juridiko-formale nuk është e një karakteri të papersëritshëm, atëherë gjykata e faktit do të duhet të sigurojë rimarrjen e saj, konform dispozitave procedurale penale”*

Në bazë të nenit 440 dhe 447 të *K.Pr.Penale*, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjatë hetimit gjyqësor të kësaj çështjeje ka qenë e obliguar që të respektojë dhe t’i përmbahet Vendimit nr 555 datë 03.12.2008 të Gjykatës së Lartë, për çdo çështje të së drejtës që është vendosur në të, si dhe të zbatojë detyrat dhe konkluzionet e këtij vendimi të Gjykatës së Lartë.¹⁰²

Rast praktik 3. Trafikim i brendshëm i një të miture. Prokuroria për

¹⁰² Vendimi nr. 47 datë 28.07.2009 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Krime të Rënda mbi bazën e materialit të dërguar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ka regjistruar në datën 16.07.2010 procedimin penal nr.71 në ngarkim të të pandehurve B. U., D. U. dhe T. T. për veprën penale “Trafikim i të miturve”, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal.

Rrethanat e faktit: E dëmtuara e mitur M.H, banon në Durrës me prindërit, dy vëllezërit dhe tre motrat. Çdo ditë e dëmtuara shkonte në Portin e Durrësit ky lypte dhe paratë që fitonte i çonte në familje. Në muajin korrik 2011 ndërsa lypte në Portin e Durrësit është njohur me të pandehurin B., i cili i ka thënë se do të shkonte me të në Tiranë për të punuar. E dëmtuara e ka pyetur se çfarë pune do të bënte dhe i pandehuri i ka thënë se “do të shkonte me njerëz me lekë dhe lekët do t’i ndanin bashkë”. E dëmtuara ka pranuar dhe bashkë me të pandehurin Bledar kanë udhëtuar me tren nga Durrësi për në Tiranë. i pandehuri B. e ka çuar fillimisht të dëmtuarën në shtëpinë e tij në Lezhë, ku e ka prezantuar të dëmtuarën me familjen si “nusen” e tij. E dëmtuara ka qendruar dy netë në shtëpinë e të pandehurit B. dhe më pas janë nisur bashkë për në Tiranë.

Në Tiranë i pandehuri B. e ka çuar të dëmtuarën tek lulishtja pas godinës së Pallatit të Kulturës, ku ka filluar të ushtronjë prostitucion me klientët që gjente i pandehuri. I pandehuri B. U. gjente klientët, kurse të pandehurit D. U. dhe T. T. ruanin të dëmtuarën që të mos largohej prej tyre. Për çdo marrëdhënie seksuale e dëmtura fitonte 5 mijë deri në 10 mijë lekë dhe të gjitha fitimet ia dorëzonte të pandehurve B, D dhe T. i pandehuri B. e keqtrajtonte sistematikisht të dëmtuarën për ta detyruar të fitonte më shumë pará. Ai i thoshte vazhdimisht: “...shko dil puno me klientët”. Ai e rrihte dhe godiste me thikë në trup dhe këto dëmtime janë ekzaminuar nga mjeku ligjor. Ndërkohë që e dëmtuara detyrohej të prostituonte familja e saj kishte kallëzuar në polici faktin e mosgjetjes së saj. Vëllai i saj E. vihet në dijeni se motra e tij po shfrytëzohej si prostitutë në Tiranë dhe niset nga Durrësi për ta gjetur. Tek lulishtja pas godinës së Pallatit të Kulturës, ai gjen motrën bashkë me të pandehurit dhe fillon të debatojë me të pandehurit, të cilët nuk donin ta linin të dëmtuarën të largohej prej tyre. Në këto rrethana, E. nuk ka mundur të shkëputë motrën prej të pandehurve. Të nesërmen në datë 16.07.2011, E. dhe i ati G. kanë shkuar tek lulishtja pas godinës së Pallatit të Kulturës, ku forcërisht kanë marrë të dëmtuarën dhe janë paraqitur në polici. E dëmtura ka dëshmuar se është detyruar të prostitutojë për rreth një muaj në vende të ndryshme në Tiranë dhe fitimet ia dorëzonte të pandehurve. Dëshmia e të dëmtuarës përputhet me dëshminë e shtetases R. Z. ka shpjeguar se e ka parë të dëmtuarën afër lokalit “Tajvan” në Tiranë me të pandehurin

B. Ajo ka dëgjuar B. që e urdhëronte të dëmtuarën: *“hajde shpejt të bëjmë lekë”*. Akt ekspertimi mjeko-ligjor ku përcaktohet se: *“...në trupin e viktimës gjenden 4 cikatrice në krahun e djathtë. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjete të mprehta siç mund të jetë thikë...”*.

Argumentimi ligjor: Gjykata pasi ka shqyrtur provat në tërësi ka arritur në përfundimin se rekrutimi i të dëmtuarës nga të pandehurit është bërë me qëllim shfrytëzimin e saj si prostitutë për të fituar të ardhura financiare. Pra, rekrutimi i të dëmtuarës nuk është bërë rastësisht nga të pandehurit, por ai është bërë me një qëllim të caktuar për të përfituar nga shfrytëzimi i saj si prostitutë. Si rrjedhojë, e dëmtuara ka ushtruar prostitucion në vende të ndryshme në Tiranë, tek kodrat e liqenit artificial dhe pas godinës së Pallatit të Kulturës. Gjatë ushtrimit të prostitucionit e dëmtuara ka qenë gjithmonë në praninë e tre të pandehurve, të cilët e ruanin. Fakti i shfrytëzimit të të miturës si prostitutë provohet nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dëmtuarës. Gjatë kësaj kohe e dëmtuara i është nënshtruar dhunës së kryer kryesisht nga i pandehuri B.U., i cili ka rekrutuar të miturën.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr.46, datë 27.07.2011 ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit B.U. për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij përfundimisht me 15 vjet burgim dhe 6 milionë lekë gjobë. Deklarimin fajtor të të pandehurit D.U. për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij përfundimisht me 15 vjet burgim dhe 6 milionë lekë gjobë.*

Deklarimin fajtor të të pandehurit T. T. për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal dhe në zbatim të nenit 51 të Kodit Penal dënimin e tij përfundimisht me 7 vjet e 6 muaj burgim dhe 6 milionë lekë gjobë.

KOMENTAR I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Bibliografi:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, të ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”.
- Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit adaptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006.
- Vendimi Kudarë i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal e datës 15.03.2001.
- Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të e 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbrojtjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.
- Konventa e Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10 071 datë 9.2.2009.
- Kodi i Procedurave Penale të RSH, sipas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.
- Kodi Penal i RSH.
- Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”.
- Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 ”Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10 173 datë 22.10.2009 dhe ligjin nr. 32/2017 datë 30.03.2017.
- The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985). URL: <http://www.unhchr.ch>.
- Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997).URL: www.unhchr.ch.
- Vendime të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Gjykatës së Lartë: www.gjkr.gov.al.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Simoni, Sandër

Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve
njerëzore : të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë

procesit penal / Sandër Simoni, Aurela Anastasi,

Elizabeta Imeraj ; OSCE ; red. shkenc. Juliana

Rexha. – Tiranë : Graphic line-01, 2017

82 f. ; 17X24 cm.

ISBN 978-9928-4472-1-0

I.Anastasi, Aurela II.Imeraj, Elizabeta

1.E drejta ndërkombëtare penale 2.Trafikimi i qenieve
njerëzore 3. Të drejtat e njeriut 4.E drejta penale

343.54(496.5)